



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË SHATË Ë TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.07.2022 (e Premte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Sokol Shaqiri Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Ekrem Ymeri, Arbnora Hajredini, Jakup Demiri Liridona Bislimi, Sejdi Emimi, Nexhat Halili, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Majlinda Shabani, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Vilsona Maliqi-Salihu, Veton Ramadani, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi, ndërsa mungoj Taibe Ibrahimimi, Zyrafete Rama Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e shtat të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm gjatë kësaj periudhë kemi konfirmimin e ligjshmërisë i të gjitha akteve përveç një akti vendim për pajisje me lloptop dhe vendimi e seancës se kalume për emërtimin e shkollës se mesme për të cilin ende nuk kemi marr konfirmim të ligjshmërisë, ndërsa të tjerët janë kthyer konform ligjshmërisë, pra se me fillu me rendin e dite kërkoj që të ju përmbahemi rregullores se punës. Zakonisht e kemi praktiku kur e kemi raportin e kryetarit, pyetjet jashtë rendit të ditës i kemi hek, e i diskutojmë tek raporti i kryetarit. Për këtë seancë materialin e kemi marr me kohe. Kemi edhe një vërejtje rreth fotokopjimit të materialit. Për këtë seancë kemi këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt e KK-së.
2. Informatë (Raport) i kryetarit të komunës për periudhën Janar-Qershor 2022.
3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar - Qershor 2022.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2022.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2023.

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendim, me numër të Protokollit 01-110/05-216 të datës 04.03.2019.
8. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankndandit publik me numër protokolit 01-110/05-476, të datës 04.05.2022.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel lokal në mes të dy komunave, Bashkia e Tiranës njësia Administrative Krrabë dhe komuna e Vitisë.
Hapi debat për diskutim për rendin e ditës. Pasi që nuk ka, e qes në votim për miratim. Prezent janë 24 këshilltar. Me votat e të gjithëve miratohet rendit i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a gjashtë e rregullt e KK-së

z.Bekim Azizi, Kryesues i kuvendit: Hapi debat për diskutim për pikën e parë të rendit të ditës.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të gjithë të pranishmit. Për procesin e kaluar i kemi mbet borxh Liridona Bislimit, e cila ka kerku që, Varrezat e Dëshmorëve nuk janë të pastra. Unë e kam mbajt një mbledhje të shërbimeve publike, ku komisioni ka qenë prej 4 anëtarëve, te cilët një anëtar nuk ka marr pjesë për shkak se është në vend të huaj, znj.Taibe dhe në bazë të kolegeve që kemi diskutu brenda në mbledhje, kemi dal në vendin e ngjarjes në të gjitha përmendoret që janë në Viti, po më së shumti kemi dal te këto që janë në qendër të Vitisë. Kemi qenë te Varrezat e Dëshmorëve, atje kemi qenë te “Bafti Haxhiu”, te Rexhepi, në qendër kemi qenë te Njazi Azemi, në Sodovinë te Gursel e Bajram Sylejmani, të cilat të gjitha kanë qenë në rregull. Pastërtia ka qenë në nivel, nuk besoj qe ka as në Kosovë, është e gjitha në rregull me pastërtinë e tyre edhe unë ju kisha thënë, se njerëzit mos të merren me fjalët për me i ja rikujtu njerëzve qe kanë vdek dëshmorët me ja u hap varret e tyre njerëzit me mëndu qe kanë vdek për së dyti. Tash unë kisha thënë më mirë mos me gënju. Kaq kisha pas, në mënyrë të sigurtë mos me u marr me çështjen e njerëzve që kanë vdek. Ne duhet me punu për ta, jo me u marr me ta.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ky diskutimi i Liridones e paska bë një punë të mirë, që për shembull ju si komitet keni dal i keni parë qe janë të gjitha mirë. Po ju kisha kërku që, vetëm brenda rendit të ditës. Diskutimi është çka ka me diskutu rreth procesverbalit. Nëse ka ndonjë vërejtje për atë qe është shkru në procesverbal.

z.Ramadan Deliu: Unë nuk kame diskutu, po aty është emri im.

znj.Lindita Demelezi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në këtë procesverbal, te faqja e 4, te diskutimi im, gati se në tërësi nuk përputhet me fjalimin tim, andaj kërkoj që të rishikohet dhe të përimtohet.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë! Te procesverbali në replikën që kam parashtru në lidhje me drejtorinë e shkollës, nuk figuron këtu hiq. Kërkoj qe te futet ne proces.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam sugjerim ne faqen 4. Te diskutimi është një pyetje që shkon në drejtori, është pyetja drejtuar për drejtorin arsimit, drejtoreshën e shëndetësisë, nënshkrues do të jete komuna. Këtë pyetje e kam bë lidhur me kontratat kolektive. E kërkoj të ndëgjohet edhe njëherë ingjizimi dhe të përmirësohet.

z.Musli Neziri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Te pjesa e procesverbalit, konkretisht te diskutimi im, te faqe 4 aty është thënë se për shkak të financave kompania “Ekohigjienes” për të cilën është diskutu kam thanë se është 54 mijë euro, e kam cek aty humbjen që ka pas për kategorinë e luftës. Këtu është 4 mi euro është një gabim teknik, mendoj gabime gjuhësore po përsëriten pothuajse në çdo seancë po ka gabime gjuhësore shumë, domethënë përveç faqes se parë që është në rregull faqe 10 prap te diskutimi im, këtu është diskutu

shkolla “Safet Rexhepi” dhe “Skender Emerllahu”, e jo Skender Hajrullahu. Pjesa tjetër domethënë diskutimi që është shkru kogja shumë nuk përputhet me ato që është fol. Te faqja 11 kam thanë, një profesor, një mësimdhënës i cili ka provojë pune 20 vite, këtu shkrun ngarkesë mësimdhënës dhe ngarkesë, nuk u lidhke kurgja. Unë e kuptoj që ndoshta është ngarkesë për stafin me përsjellë krejt diskutimin tonë dhe me shkru që është e kuptueshme ajo, po megjithatë besoj që duhet me u korrigju mos me ba kësi lëshime.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Se ne këtë muaj ka qenë edhe Fatlumi në pushim e procesverbali është ba nga pjesa e stafit që janë pa provojë në këtë çështje.

z.Illir Zuka: Sapo deshta me than kryesues, e di qe ka gabime ne shkrim, duhet me pas konsideratë, se ai djali që e ka shkru e ka be si libër, se fjalë për fjale e ka shkru, nuk e ka ditë se si shkruhet një procesverbal.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket procesverbalit, ky është një dokument i cili na i dokumenton te gjitha te bëmat dhe te thënat ne këtë kuvend. Te diskutimi im e kam lexu ne tërësi, mirë që e di çka kam thanë, se përndryshe nuk do ta kisha kuptu. Unë propozoj që të hiqet si pikë e rendit të ditës dhe të sjellët në një seancë tjetër, sepse është një procesverbal me shumë gabime gjuhësore, po ashtu ka edhe gabime përmbajtësore, të cilat vërtet pak kush mund t’i dëshifroj kështu si është, prandaj unë propozoj që të tërhiqet të vijë me një mbledhje tjetër ashtu si duhet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Procesverbali është i pa lektorur edhe është ba nga personat që nuk kanë pas provojë. Mungesa e Fatlumi me një kontroll të Fatlumi që do ta përcjellë dhe lektorit të zyrës, seancën e radhës e miratojmë. A jeni që në seancën e radhës te miratohet procesverbali. Me 13 vota pro, 11 kundër, 0 abstenim, kjo pikë mbetet të sjellët në seancën e radhës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi

2. Informatë (Raport) i kryetarit të komunës për periudhën Janar-Qershor 2022

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kryetari do te bashkëngjitet ne vijim, unë do të bëjë përpykje që në pika të shkurtra me lexu raportin edhe pse ju e keni marrë me kohë, po ajo që është inkurajuese është një përgjegjësi e kryetarit. Raportin e punës që e ka përgatit dhe e ka sjellë para jush, së bashku me drejtorat që kanë meritat e veta, kam kënaqësinë që para juve sot të prezantoj punën e organeve komunale, ku do t’i paraqes të arriturat për 6-mujorin e parë të këtij viti si dhe sfidat për të cilat jemi përball gjatë kësaj periudhe për të cilat po raportohet. Më lejoni që me sinqeritetin më të madh institucional dhe qytetarë të ju falënderoj të gjithë juve këshilltarë te nderuar për bashkëpunimin e ofruar të rekomandimeve dhe njëkohësisht vërejtjeve që keni bë te shërbimet të cilët i ofron komuna dhe të cilat jemi munduar t’i përmitojmë me përkushtimin më te madh institucional. Qeverisja e mirë në komunën tonë ka qenë dhe do të jetë në objektivat tona kryesore dhe në përputhje me planin tonë strategjik në të cilin planë synojmë të kontribuojmë në përmirësimin e shërbimeve komunale. Modalitetet e qeverisjes tonë janë karakterizua me ngritjen e performancës në të gjithë sektorët, cilësinë e shërbimeve si dhe transparencën komunale. Politikat publike të komunës dhe harta e investimeve komunale janë tregues më te mirë se, Komuna e Vitisë ka shënuar rritje të besimit politikë të qytetareve, grupeve të organizuar me interes siç janë bizneset dhe shoqëria civile në përgjithësi, janë rritur parametrat të vlerësimit të punës, është rritur cilësia e punëve në infrastrukturë, si rrugë, kanalizim, ujësjellës, mbrojtje të mjedisit e të tjera. Sa i përket funksionimit të shërbimit civil të Administratës Komunale të Vitisë, shërbimi civilë është i paanshëm dhe i përgjegjshëm, ku këtë e dëshmon më së miri klima antidiskriminuese që është krijuar në administratë dhe si çdo shërbyes civil i është krijuar hapësira e nevojshme e veprimit për t’i shprehur aftësitë e veta profesionale që ka rezultuar edhe me ngritjen e efikasitetit të punës në administratën komunale. Raporti prezent pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën Janar-Qershor 2022 tek të gjitha organet komunale, duke përfshirë njësitë, zyrat e kryetarit si dhe drejtoritë komunale me drejtorët e tyre, me prioritet si në vijim: rritja e efikasitetit në administratë,

zhvillimi i bujqësisë, shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti, infrastruktura lokale, shërbimet publike, zhvillim ekonomik, përkrahja për shtresat e varfër dhe grupet e marginalizuara, bashkëpunim me shoqërinë civile dhe donatorët, mbrojtja e ambientit dhe kualiteti. Në vijim do t'i prezantojmë aktivitetet e drejtorive komunale, ku jetësimi i këtyre aktiviteteve ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve të komunës sonë.

Administratë: Drejtoria e Administratës ka hartuar shërbimet më kualitative për qytetarët, është zvogëluar koha e pritjes për shërbime pas sistemit të avancuar të teknologjisë informative, janë lëshuar 121 mijë e 483 dokumente, numri i qytetareve që kanë kaluar verifikimin në sistemin e gjendjeve civile është 55 mijë e 806.

Bujqësia: Kanë përfituar shumë fermer në lëmin e bujqësisë, si segment kyq i zhvillimit ekonomik të komunës sonë, është bërë aplikimi i 1058 fermerëve për subvencione si për grurë, misër, perime në fushë të hapur, dele, e të tjera dhe pse afati kohorë ka qenë i shkurtër, por është mobilizuar i gjithë stafi që mos të ngelë asnjë fermer pa aplikuar dhe ky aktivitet është kryer me sukses, kanë përfituar 50 fermer me foli të zezë, është iniciuar procedurë për furnizim me kultivator për fermer dhe është bërë thirrja për aplikim për ngritjen e pemishteve, por në mungesë të aplikimit nga ana e fermerëve, ky aktivitet ka dështuar, është iniciuar procedura për furnizimin me farë të misrit, por për shkak të ankesave në organ shqyrtues të prokurimit publik nga ana e kompanive dhe mungesa e bordit të OSHP-së. Ky projekt ka dështuar, për shkak të vonesave janë mbyll me eskavator 3 rrugë që kanë ndikuar në zvogëlimin e shpenzimeve të hyrave. Janë mbajtur trajnime dhe këshilla për fermer të Vitisë, janë duke u bërë përgatitjet e nevojshme për fushën korrijshirje, jemi në përgatitjet e linsimit të procedurave për furnizime me spërkaste në bashkëpunim me Agjencionin Pyjor të Kosovës janë planifikuar 15 hektar. Më gjerësisht, materialin e keni marrë me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! E falënderojmë nënkryetarin për sqarimet që i dha në kuadër të punës së kryearit për periudhën Janar Qershor 2022, duke u nisur prej zyrave që janë në komunë, Zyra për Barazi Gjinore, Zyra Ligjore, Zyra e Avokatit të Komunës, Zyra për Integrim European, të gjitha këto zyra kanë punu dhe kanë kry obligimet në harmoni me ligjet që janë në fuqi të Republikës së Kosovës. Me hyrje me i cek punët dhe të arriturat nuk po i hy me ju lodh, se edhe nënkryetari i elaboroj dhe i shpjegoj të gjitha, është punu në mënyrë të përgjegjshme, të gjitha punët që kanë qenë të parapara në Zyrë të Kryetarit në përgjithësi dhe mënyrë ligjore i kam përcjell të gjitha aktivitetet e kryetarit, kryesuesit, pritjet e delegacioneve vendore apo të huaja dhe ka bërë informimin e duhur përmes web faqes së komunës për qytetarët e Komunës së Vitisë. Një punë të mirë është bërë edhe në Zyrën e Projekteve, që është zyrë e kryetarit. Nëse ndalim e shofim punën e drejtorive që janë dhjetë, Drejtoria e Administratës deri tek Drejtoria e Katastrit, puna që është bërë, kisha potencu tek Drejtoria e Bujqësisë janë bërë aktivitete, subvencione, është vlera e investimeve të projektet kapitale, që kap vlerën 4 milion e 576 mijë 786 euro. Sa për fillim këto, e ndërkohë nëse është nevoja prap do të kyqemi në debat kryesues. Ju faleminderit!

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit e kam një pyetje apo shqetësim të qytetareve, të ndërtimet pa leje, është fjala pikërisht për një ndërtim të pasqyrja që është ngritë dhe të vazhdoj me ndërtim të kaloj entazhitetin sikur kanë ndodh tek të tjerët. A do të ndërmerr komuna diçka në këtë drejtim, sepse e dimë se si ka ndodhë në vitet e kalume, si kanë vepru. Këtë pyetje e kam edhe për kryetarin edhe për drejtorin e inspeksionin.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Un i kam 2, 3 pyetje tek raporti i kryetarit. Pse shkëputet kontrata për asfaltimin e rrugës Viti-Sllatinë? Operatori ekonomikë ka pas shumë vërejtje. Ne nuk kemi mujt me vërejtje të shkëputja e kontratës, këtu e ka demtu shumë buxhetin e komunës. Sipas Ligjit të Prokurimit, shkëputjen e kontratës duhet ta bëjë shefi i prokurimit ose kryetari i komunës, jo menaxheri. Sa do t'i kushton buxhetit të Komunës së Vitisë kjo shkëputje. Ne e dimë që operatorit i konvenon kjo shkëputje. Zotëri Aliu i përmendi investimet të parku i biznesit që janë bërë do shpenzime dhe të salla sportive në Drobesh, të palestra sportive. Palestra sportive në Drobesh, është viti i 9-të që ka fillu, do me përfundu kryeatri Haliti mandatin e 3 dhe palestrën ende se kemi. Te parku i biznesit, edhe këtu kemi filluar që 3 vjet, ka shumë biznese

të Vitisë të interesuar që aty të punojnë, veprojnë. Vetëm ta dinë qytetarët kur e ka naj farë afati kohorë, a varet prej ministrisë përkatëse apo kur munden qytetarët e Vitisë ta kenë parkun e biznesit? Pe shof që televizioni plus nuk është këtu, nuk është pjesë e kësaj seance, nuk e di pse nuk është lidhë kontrata me një televizion lokal. Ne jemi përfaqësues te popullit, ne jemi këtu për me i diskutu interesat e qytetarëve. Qytetarët e Vitisë duhet të na shohin në televizionet lokale, duhet ta dinë qytetarët e Vitisë, pse nuk është lidhë kontrata me ndonjë televizion lokal. Ne i kemi disa televizione lokale.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Po mundona me u ndërlidh pak a shumë me informatën e punës se kryetarit për periudhën janar qershor i kom të specifikume disa pika e para po du me u lidh te Njësia e Auditimit të Brendshëm është vetëm kërkimi i auditimit nuk është se çka duhet këtu me pas. Po du me u ndërlidh te Zyra Prokurimit, ku aktivitetet janë gjithsej 43 aktivitete. 21 janë të finalizuara, 22 në zhvillim, 2 janë anuluar. Kisha dhanë propozim dhe mendoj që është mirë me u raportu edhe me figuru këto aktivitetet. Përshembull te këto dy aktivitete që janë anuluar nuk e tregon arsyen pse një shembull shumë të mirë te aktivitet që janë bë e kam pa tek Sektori për Punë Administrative, është raport detajik. Gjithashtu thuhet që bëhet mbarëvajtja ne komunë dhe respektimi i dispozitave ligjore në fuqi. Sa kam informacion, Zyra e Prokurimit gjatë vitit 2018-2020 e ka bë ndarjen informimit për kontraktimin e një kompanie private që këtë shërbim me kry tek investimet kapitale. Mendoj që edhe kjo është me rëndësi që me u bë mbikëqyrja e investimeve që bëhet ne treg. Gjithashtu kërkuj qe, është kryetari me e shtu transparencën e tij. Sa i përket investimeve që bëhen është mirë mu realizu një monitorim, një skanim i punëve qe po investohen, me e ditë qytetarët cilat pune kanë përfundu e cilat jo. Tek e dyta po du mu ndërlidh, përshembull, tek Sektori i Punëve Administrative janë të cekta emërtimi, është taman qysh duhet. Tek kjo zyre ceket 43 aktivitete, 22 janë realizu, 20 të parealizume, 2 janë anuluar, ama çfarë aktivitete kanë qenë nuk figurojnë, e mënoj që është mirë me qenë në raport, se nëse thomë që është raport, duhet me ditë çka, është raporti. Pa marr parasysh, mendoj që raporti është një dokument zyrtar dhe mendoj që është mirë me qenë. E dyta ka të bëjë me projektin investimet kapitale për vitin 2022, du më u ndërlidh tek investimet ku ka të bëjë ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik është shuma e ndarë, dikun 370 mijë euro, mirëpo e kam parë te raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës është gjendja e auditorit. Pak a shumë e kisha nderlidh shkrun qe ka qenë në vitin 2021, gjithashtu ka qenë shuma 370 mijë euro, shpenzimet për këtë projekt kanë qenë dikun afër 7493 euro. Kisha dashtë me ba pyetjen, a është bë bartja e mjeteve për vitin 2022 për shkak që është e njëjta shumë 370 mijë. 370 mijë nëse flasim për periudhën 6-mujore, mendoj që i kish ra me qenë dikun 272 e 307, 370 mijë jo gjithsej. Te Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente figuron që janë dikun 60 intervenime në rregullimin e kanalizimeve, ujësjellësit e te tjerë, gjë e cila tregon për natyrën e punës së komunës, e cilësisë se dobët, që natyrisht gjithmonë ka nevojë për intervenime. Për sa i përket periudhës, kemi pa që ka pas mangësi në pastrimin e trotuareve. Shkurret, shembull muj me cek fshati Lubishtë ku ka qenë trotuari i pa shfrytëzueshëm, i pakalueshëm, pikërisht prej barojave. Drejtoria për Arsim është cekur tek sektori i financave. Kisha bë pyetje, thuhet se është bërë pagesa për transportin për nxënësit te cilët vijnë nga shkolla fillore. Kisha dashtë me ditë në cilat shkolla është bërë kjo pagesë edhe mjetet, se sa ka kushtu, sa ka qenë ajo pagesë. Tek Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural janë cek aktivitetet që janë bë, mirëpo mu më ka interesu dhe ka qenë shumë shqetësuese totali i investimeve në bujqësi nga Komuna e Vitisë në 6-mujorin e parë është dikun 42 mijë e 860 euro, që është një shumë shumë e ulët, tu e marrë parasysh që qekjo periudhë 6-mujore është periudha kur të mbjellat edhe aktiviteti i bujqësisë zgjerohet në përgjithësi. Mendoj që ish dashtë me qenë prioritet prej anës komunës, që ndoshta mjetet me qenë pak a shumë më shumë të orientume. Tek sektori i bujqësisë është shuma 42 mijë euro, një shumë shumë e ulët. Mendoj që si komunë nëse ndërlidhem për qetë 6-mujorshin e parë, njëra prej dështimeve prej anës teme ndoshta është kjo për shkak të investimeve shumë të ulëta.

z.Musli Neziri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Meqenëse nënkryetari i laboroj punën e gjashtëmujore dhe konkretisht tek projektet të cilat tek trotuari këtu që e ceku, unë kërkuj që këtu të rritet

dinamika e përmirësimit të punëkryerjes. Përshebull i kemi plotë lokacione që kanë fillu ndërtimi ose rregullimi i trotuareve po nuk është përfunduar, domethënë në disa lokacione ka filluar, domethënë këtu duhet të marrim përgjegjësi ma shumë tek kompanitë punëkryerëse që t'i përfundojnë. Sikurse njëjtë kërkoj edhe tek rrethojat e fushave që janë duke u bërë. Një pyetje e kam për drejtorin e inspeksionit, konkretisht te orientimi ose me tabelat orientuese që janë të komunikacionit, në bashkëpunim edhe me inspektorin e komunikacionit kisha dashtë me ditë pse puna po vonohet. Kompania e cila ka tenderin është një kompani nga Prizereni. Me sa e di dhe ajo punët që po i kryen po merr shumë kohë. Unë vet kom ba kërkesë për me i vendos shenjat. Diku 4 muaj kemi prit, kisha dashtë me ditë çfarë kontrate ose afati a ka përgjegjësi ajo kompani a e mirëmban. Pyetjen tjetër e pata për drejtoreshën e arsimit, kisha pas dëshirë me i sugjeru që është mbledhja e fundit për këtë pjesën e parë që do të fillon viti i ri i arsimit, domethënë do të filloj viti 2022/2023. Një diçka që më ka rrjedh nga shoqëria, si shqetësim kisha pas dëshirë me kërku festimi i ditëlindjeve nëpër shkollat në klasë të nxënësve dhe mësuesve të ndalohej. E kemi pas edhe ne etiken e punës që e kemi diskutu. Këtu kisha pas dëshirë që në shtator të shkojë një vendim ose një urdhëresë që të ndalohen festimet nëpër klasa, goftë edhe në administratë, kudo që të jenë ditëlindjet, në çdo aktivitet të festohen nëpër restorante. Dhe e fundit është prapë tek drejtoresha e arsimit ose tek kryetari i komunës rreth shqetësimeve për ndërtimin e çerdhës së re që e kemi pas. Ne e dimë kemi marrë një vendim këtu, kemi ndarë një parcelë, e kemi lokalizuar atë vendin aty ku duhet ndërtohet. Tani në media shkruan që ajo është anuluar ose është bartë në Kamenice. Sa është e vërtetë? Kisha pas dëshirë me ditë ku janë procedurat e saj, cili do të përgjigjet çka është bërë me këtë pjesë.

znj.Liridona Bislimi: Përsheundetje për të gjithë të pranishmit! Së pari duke e marrë parasysh se sa shumë tema të rëndësishme u shtjelluan gjatë kësaj seance, është dëm i madh për qytetarët të cilët nuk informohen drejtpërdrejtë përmes mediave atë që ne e diskutojmë, por besoj që një gjë e tillë nuk duhet të përsëritet në seancën e radhës, për shkak se atëherë e kemi një temë që është mjaft në interes për qytetarët tanë. Sa i përket raportit të punës të 6-mujorit të parë, pa dashur të hyjë në ripërsëritje të atyre që u thanë më herët në fillim, du me e cekë se si raport puna e këtij materiali të prezantuar përgjithësi të len me kuptu pjesa dërrmuese e përshkrimit i punës së zyrës së kryetarit dhe drejtorive të komunës dhe si informatë është e njëjta si në vitet paraprake për nga struktura e saj, i përgatitur joprofesional, duke futur në të një mori informatash jo të nevojshme, e një pjesë e këtij raporti është i palexueshëm Askund nuk gjen se cilat janë ngecjet dhe problemet të cilat I kemi si komunë, por prezantohet si material voluminoz vetëm për të krijuar një përshtypje se është punuar më shumë. Te përmbledhja ekzekutive ku përshkruhet puna e kryetarit, nuk gjen asgjë tjetër të shkruar veçse përshkrimin e punëve të zakonshme që I bën kryetarit dhe drejtoritë, ndërsa te projektet dhe investimeve, tashmë të gjithë qytetarët e dinë se çfarë pune bëhet ashtu si u cekë më herët. Në përgjithësi këtë qeverisje komunale secili qytetar vazhdon ta mbajë mend si qeverisje e asfaltit dhe rrugëve me zhavor, e arsyeja pse bëhet kështu kryetar, tashmë dihet për shkak fitimit të madh. Si shqetësim për këtë raport, vlen të ceket se edhe në këtë mandat të tretë qeverisës, shkollat në Komunën e Vitisë nuk kanë ngjyra dhe fleta të mjaftueshme për printerët e tyre dhe mësuesit tanë janë të detyruar t'i grumbullojnë mjetet vetëm për me e pas mundësi me printu planprogramin edhe testet në shkolle. Sipas Planit vjetor, nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë planifikuar të përfundohen dy auditime për gjashtëmujorin e parë, ndërsa është kryer vetëm një auditim, pra ka pasur ngecje dhe një moskoordinim dhe mos menaxhim me implementimin e projekteve kapitale. Nëse shikojmë planin e prokurimit, komuna ka inicuar 43 aktivitete për gjysmën e parë të vitit 2022, vetëm 21 janë përmbyllur si aktivitete tjerat janë ende në procedurë pse kjo vonesë apo neglizhencë në realizimin e ofrimeve të shërbimeve nga zyra e prokurimit vit pas viti sipas pasqyrave financiare, Komuna e Vitisë vazhdon ta shpenzojë paratë publike nëpërmjet vendimeve gjyqësore, pikërisht tek ata operator ekonomik ku pagesa nuk është bërë në kohë. Po ashtu atë çka e ka raportuar Zyra e Projekteve, nuk ka dhënë informacione të sakta për periudhën që është raportuar, nuk jepen të detajuara për pranimet teknike, sa projekte nuk I kanë plotësuar kushtet, sa prej tyre nuk janë të cilësisë së mirë dhe cila është qasja e komunës sipas këtij raporti rezultojn se edhe Komuna jonë edhe në këtë vit ka vazhduar të mbes pa Mamograf Mobil dhe kjo është diçka mjaft shqetësuese kur e dimë se kanceri i gjirit është një ndër vrasësit më të mëdhenj për gjininë femërore. Për Drejtorinë e Arsimit, ndër shqetësimet më të mëdha vlen të ceket uji i kontaminuar, që vazhdon t'i furnizoj nxënësit tanë në

dhjetë shkollat e komunës sonë, që për këtë gjë ka pasur urdhër nga Drejtoria e Inspeksionit të ndërmerret masa urgjentisht në këtë aspekt dhe siç dihet ende nuk kemi asnjë veprim, shkollat në komunën tone vazhdojnë të pastrohen me batanije dhe ka nevoja elementare për produkte higjienike. Si Lëvizja Vetëvendosje kemi bërë vazhdimisht rekomandime me të cilat kemi besuar fuqishëm se do kishin dhënë kontribute pozitive, por që fatkeqësisht këto rekomandime gjatë këtij raporti të punës së kryetarit siç shihet nuk u morën parasysh fare.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë pak po ndërlihdna rreth kësaj informate, ku potencoj nënkryetari, se janë rritur parametrat e vlerësimit të punës, është rritur cilësia e punës së infrastrukturës, si rrugë, kanalizim, ujësjellës, mbrojtjes së mjedisit, e të tjera. Unë e kam një pyetje te pastrimi i rrugëve si sezones verore ato edhe dimërore nuk qëndrojnë në nivelin e duhur. Pak po ndërlihdna te Zyra e Auditimit, ku paraqiten 4 auditime. 2 auditime në 6-mujorin e parë dhe 2 auditime në 6-mujorin e 2. Tek zyrtari që është në Zyrën e Auditimit është vetëm një zyrtare dhe është drejtori, edhe pse sipas rregullores parashihet çdo autoritet kontraktues ose institucion publik i cili ka buxhet mbi 7 milion, duhet të ketë në Zyrën e Auditimit të paktën 3 zyrtar, por mund të ketë edhe më tepër dhe për atë arsye është edhe moskryerja e punëve. Te Zyra e Prokurimit shof një raport, por raport i mangët. Ky raport duhet të jetë më i detalizuar, do të kishim mundësi me i bë analiza më ndryshe. Në bazë të këtij raporti nuk mund të bëjmë asnjë analizë. Vetëm një shembull, 2 aktivitete janë të anuluar, mirëpo me hi me i kqyr nuk dalin 2, por dalin më tepër. Tek Zyra e Projektit potencohet këtu se, kemi punuar në hartimin e projektit. Çka ka pas nevojë Zyra e Projekteve me punu në hartimin e projektit, kur e ka kontratën për hartimin e projekteve e cila e ka deri me 23.03.2023, që është kontratë publike. Tek Drejtoria e Administratës, e kam një pyetje për drejtorin e administratës: pse nuk funksionon gjeneratori tek objekti i ri dhe objekti i vjetër? Unë para 1 jave ose 2 isha me nxjerrë një dokument te kadastrë, rryma u nal, mu deshtë me u kthy mbrapa. Tek shërbimet publike, mirëmbajta e rrugëve e kompanisë “Zuka”. Unë po tregoj të drejtën, po të isha në komision të pranimit nuk do të ja pranojsha, se punët i ka bë shkel e shko. E kam edhe një pyetje tek drejtoria e shëndetësisë. Drejtoreshë, a keni ndonjë program, a keni parapa në Komunën e Vitisë një barnatore të funksionon 24 orë? Unë isha në ambulanten në Pozheran, stafi ishin në nivelin e duhur, mirëpo nuk kishin barna, recetën e kishin shkru për me i marrë barnat, por në Komunën e Vitisë nuk punon asnjë barnatore 24 orë. Edhe një pyetje tjetër e kam, tek prokurimi, i cili lidhet me kontrata 2-vjeçare. Këto kontrata kanë fillu gjithmonë ka 2 vite, eventualisht 3 vite deri sa ka ardh puna mu ndërpre edhe kontrata e rrugës Viti-Sllatinë. Ne e kuptojmë që ka ndryshim të çmimeve dhe e kuptojmë që operatori nuk punon me humbje, po të paktën në të ardhmen, ju apet po vazhdoni me këto kontrata 2-vjeçare. Domethënë fjalën e kam për punë jo edhe për furnizime dhe shërbime.

z.Durim Sylejmani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pasi që veç jemi te raporti i kryetarit, në këtë kuvend kryetari u zotë se, në këtë kuvend ka me ma ngritë një padi edhe jam shumë i interesum me marrë informatë prej tij se në cilën fazë është padia ndaj meje, se jam ka e presë me pa durim.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Të thirr gjykata për atë punë.

z.Durim Sylejmani: E kamë blejë një kostum veç për atë përballje.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë do të interesohem rreth shkollës së muzikës, është një çështje që është inicë dhe është ngritë shumë vite më herët. Dua t’i drejtohem drejtoreshës së Arsimit, të dijë në çfarë faze, ku ka mbërri kjo çështje, sa janë mundësitë që ne Shtator në Viti ta kemi një shkollë të muzikës që i plotëson kërkesat dhe nevojat e talenteve të komunës sonë. Kam parë se është hapë një konkurs për 8 psikolog. E dimë që Komuna e Vitisë ka nevojë për më shumë psikolog. Dua ta di se në cilat shkolla do të shkojnë ato 8 psikolog kur e dimë se ato nuk e plotësojnë kërkesën dhe nevojën nëpër të gjitha shkollat. Vetëm dua ta di se ku kanë me shku ato psikolog. Pajtohem me parafolësin tim Muslien, që punët duhet të shkojnë me dinamizëm më të shtuar dhe më të madhe. Kemi rastin ku në Goshicë është fillu trotuari, në seancën e më hershme kemi kërku që të rritet dinamika, të përshpejtohet puna, mirëpo fatkeqësisht jo që është shpejtu po ka ngel, kompania ka shku me punu tjetër kund, aty ka pengesa dhe barriera për qytetaret që kalojnë aty pari. Në njërin anë janë gurët me të cilët bëhet trotuari, në anën tjetër është zhavorri dhe tu kalu po ka problem, dhe mendoj që kompanisë duhet me i bë presion se është problem për të gjithë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kisha me thanë se për këtë dokument, për këtë informatë Janar Qershor, se kjo është një informatë tejet voluminoze, e cila len për të dëshiruar ngase, kemi përshkrime vetëm pa cilësi, pa pa asgjë konkrete, vetëm se përshkruhen gjërat dhe jo në mënyrë konkrete se si dhe qysh. Sa për ilustrim përmendëm dy shembuj se është kontratë thuajse e përshkruar në faqen 14. Nuk jam ekonomist, por megjithatë diçka kam vërejtur por nuk po kuptoj se a është paraqitur buxheti nëpër fushat e ndryshme apo është paraqitur diçka tjetër? Shembullin e parë si krahasim Zyra për Regjistrimin e Biznesit, gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 kanë 137 regjistruar, 91 biznese që është gjithçka në rregull. Projektet për investimet kapitale për vitin 2022 e financuar nga buxheti i Komunës së Vitisë, buxheti i nivelit qendror. Tashti shtrohet pyetja, jemi ka flasim për periudhën 6-mujore apo të projektet buxhetore të vitit 2022, në përgjithësi nuk po hy në detaje, megjithatë nuk e kam të kjart. Nuk e di për çka flitet në bazë të këtij dokumenti, pasi që çështjet e ngritura. Unë kam kërkesa prej banoreve të fshatit Skifteraj dhe një kërkesë prej fshatit Remnik, që mund t'i paraqes nga fshati Remink. Është kërkesa për ndërtimin e trotuareve. Po ashtu e kemi në fshatin Skifteraj, në rrugën “Kenan Halimi” kanalizimi del mbi asfalt. Pastaj e kemi vërejtjen te mesi i fshatit, edhe aty rrjedhë kanalizimi. Dhe një kërkesë tjetër e kam që për një vendqëndrim të autobusëve në të dalme, në rrugën kryesore për Gjilan, kjo është kërkesë nga studentet.

z.Illir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë do të flas pak për këtë 6-mujorë, po jo në nivelin lokal po në nivelin qendror, që na i ka blloku punën, na i ka blloku mbarimin e shkollës, ndërtimin e stadiumit, na i ka blloku ndërtimin e palestrës, na i ka blloku përfundimin e punëve të zjarrfikësve. Edhe çka është e fundit, e kanë marrë çerdhen që e kemi nda para disa seancave në Kuvendin Komunalë të Vitisë. Nuk e di çfarë qëllimi kanë ata kundër Komunës së Vitisë edhe nuk e di si 2 deputetë të Komunës së Vitisë nuk e marrin guximin me ngrit këtë se kanë marrë vota prej qytetareve të Vitisë. Kam prit sot prej anëtareve të Vetëvendosjes, ta ngritin këtë çështje ku do t'i regjistrojmë fëmijët në çerdhe, kur e dimë sa nxënësit vijnë nga Vitia.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kryetar, e kam një pyetje për çështjen e trotuarit në Smirë, që është ndërpre. Nuk e di se pse, është një kërkesë e banorëve se kur përfundon, dhe pse është ndërpre? Pyetja tjetër është: kur do të funksionalizohet ujësjellësi në Smirë dhe a do të ketë komuna punime sivjet në ndonjë lagje apo pjesë të fshatit për ndriçim?

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Të gjitha pyetjet janë dëgjuar me vëmendje, një pjesë e tyre janë përsëritur, po unë para se me kalu te drejtori, se zakonisht po na diskutohet çështja e mediav që nuk janë këtu besoj Fadili mund të na jap informatë.

z.Fadil Abazi: Sa i përket kontratës për transmetimin televizivë për shërbime nga ana e Komunës, një kërkesë e kam pranë, e kam udhëheq, mirëpo për shkak se asnjë operator nuk ka qenë i përgjegjshëm, përkohësisht procedura është anuluar, ndërsa tani jemi në rishpallje brenda kësaj kohe 2/3 dite, kështu që duhet afate kohore për ta arritur një kontratë.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Janë mbi 20 pika që qaj zyrtari i ka bërë sot, nuk është veç një pikë që unë ti njehi. Një pyetje është për drejtorin, qekjo që e ngriti Taulanti është për drejtorin, kjo është për inspektorin për prokurimin, për çështje ligjore, për lektorimin, tash Zyra e Kryetarit dhe drejtorit janë të gjitha bashkë dhe çka po del këtu kryesues, dy këshilltarë nga e njëjta parti po eliminohet të tjerët. Me të kallzu të drejtën, qeveria qendrore nuk i ka hiq ma kualitet dhe nëse me lejon, se të dëgjova me vëmendje. Përshembull, i përziente projektet e 2021 me 2022. Projektet 2021 janë në vazhdimësi barten në 2022, projektet e 6-mujorit të parë kanë vazhdimësi në gjashtëmujorin e dytë të 2022-ës, barabarësia institucionale krijohet kur debati zhvillohet i barabartë. Jo unë me të dëgju me fol ti çka dush e ti mos me më dëgju mu tu ti argumentu gjërat. Edhe njëherë po kthehem 2021, ka vazhdimësi në 2022 janë projekte që barten. Po du me u pergjigj profesionalisht e me kthy krejt ata që më kanë bërë pyetje. Nexhat, duke u përfshi edhe ti, ka bërë pyetje edhe dikush tjetër. Bartja e mjeteve

vetanake, të hyrat vetanake bartën, ajo është e drejtë e Komunës, të tjerat shkojnë soficit projektet për mos me shku soficit bëhen 2vjeçare, po ka projekte që imponohen 2-vjeçare përshembull. Po ta jap një shembull Nexhat, shumë me dashamirësi, kështu taman projekti i grandit të performances, që e kemi fitu. Unë e kam kërku, kam qenë në bord të asociacionit që kam kërku me u bë 2-vjeçare. A e dini pse 2-vjeçare, se ata na i kanë vanu në Korrik procedurat, hala nuk kanë dalë. Qysh ki ti mundësi një projekt të tillë 564 mijë euro me kry brenda këtij viti fiskal, ku rriski është tepër i madh për shkak se OSHP-ja nuk funksionon. Nuk po du me hi në atë që e tha Iliri, se është e vërtet ajo e nivelit qendror, e qysh mundesh ti me implementu grandin e performances me dhënë paranë e taksa paguesve kësisoj, prandaj kjo duhet të bëhet 2-vjeçare dhe viteve tjera kur punojmë me projekte të rregullt 1-vjeçare. Projekti 1-vjeçar duhet me u zotu mjete ne fillim te vitit. Qysh ki mundësi ti me qitë rrugën e Stubllës dhe të Mjakut në 6-mujorin e parë, kur ministria të shtin me rinëshkru, që nënshkrimi i Kryetarit dhe i ish ministrit nuk është valid a? Dhe mbi të gjitha nuk ta lëshon zotimin, njërën ta lëshon, njërën nuk ta lëshon, memorandumit është i përbashkët. Qe ku ka jurista këtu edhe ekonomista ju tregojnë, prandaj bëhen 2-vjeçare për shkak se ti i humb mjetet. Deshta me i thënë Remzies, kërkesat keni mundësi me i bë ju këshilltarët komunal. Ligjërish në parim qëtash me marrë pjesë në seancat dëgjimore për buxhet, ku drejtorët janë transparent, janë obligativ dhe qëky kuvendë ka me miratu me propozimin e qeverise buxhetin masë seancës degjimore për buxhet, për atë janë transparent dhe kanë llogaridhënie. Unë kam thënë për çdo vit shikoni transparenca duhet me u kërku qaty kur bëhen takimet këshilltarët bashkë me qytetaret edhe qeveria, pjesa profesionale gjithmonë s'paku mundet me ardh, nënkryetari, drejtori i financave me marr pjesë dhe si Vitia. Seancat dëgjimore për buxhet, kërkush në Kosovë nuk i mbanë si kanë mbajt asnjëherë. I inkurajoj dhe uroj që me i mbajt përsëri dhe këshilltarët me marrë pjesë dhe me shënu edhe për rrugën "Kenan Halimi" në rrugën Remnik, në Debelldeh, në rrugën Lubishtë dhe në Buzovikë, por jo për poena politik, as ti, as unë, po në parim me i shti ato rrugë, me propozu. Tash jemi tu fol për raportin 6 mujorë të këtij viti, nuk jemi tu fol për ato çka i këna planifiku në Shtator për vitin e ardhshëm, prandaj të keni pak seriozitet te profesionalizmi, masi pe kontestoni profesionalizmin. Nuk ta kisha thënë këtë fjali, po ti pe konteston profesionalizmin, prandaj nuk të tolerojë kesi injorimi, nënçmimi çfarë e bëri këshilltarja. Përshembull ja bëri fitim i madh. Kjo është skandaloze, këtu ka thënë. Këshilltari më herët e përmeni, bile më mirë është mos me përmen, se ajo fjali. Në këtë kuvend kam qenë opozitarë edhe plotë ka pas opozitarë, edhe të tjerët që janë para tij nuk e kemi përmen kurrë këtë termë, me ra kaq poshtë, se unë e di shumë më shumë dhe nuk jam tu e përmen, se duhet të ja përmeni edhe web faqet.

z.Durim Sylejmani: Përmeni krejt.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Me ty për atë temë si kuvendë jemi marr veshë kaq. Dëgjo, nuk kam kohë me u shty verbalisht, se unë nuk kam kohë me dal prej rrugës teme që jam nis me punu për interes të qytetarëve. Dëgjo, në momentin që ti bënë shkelje jashta asaj që është e nënvizume me norma demokratike, merret tjetër kush, merret edhe me web-faqet qe i kanë zbulu që janë të rrejshme, që e din këshilltarja edhe me atë merret edhe me krejt senet, edhe me Blerim Kabashin merret. Edhe kuvendi është mirë me pa se kush është Blerim Kabashi, kush është ajo faqe, kujna i ka lyp pare, çka ka bë tek ka be edhe është ingjizimi me ato sene merret dikush. Dhe janë bërë shumë pyetje parimore prej këshilltarëve, që me të vërtet unë i respektoj dhe i çmojë. Munden me fol për Njësinë e Auditimit, lirishtë është e vërtet se njëri ka shku në pension, njëri ka mbet, dy i kemi pas, por kemi nevojë për më shumë. Ju e dini kush e bënë interpretimin e ligjit, tash ata me ligj e thonë që është e parapam, por me ligj nuk të lejojnë me marrë punëtorin e tretë, punëtorin e dytë e lejojnë,

shumë frik ka me ndodhë, se për shkak se e kemi buxhetin. Trotuari në Smirë. Jakup, është tu u punu, është projekt 2-vjeçar, është tu punu në Smirë, në Goshicë, është tu punu në Fshatë të Ri, në Viti, në Ballancë. E tha edhe Musa, unë po pajtona, duhet me u ulë me kompaninë me e kqyr dinamikën, me kqyrë ku është organi mbikëqyrës Rafizi, është në pushim, këta inxhinierat tjerë janë këtu, ne mundemi me kqyrë, është projekt 2-vjeçar. Planin dinamik ne mundemi me kqyr edhe me qu përpara, insistoj edhe unë për këtë.

z.Jakup Demiri: Kryetar, janë diku rreth 300 nxënës që kalojnë në qatë rrugë edhe e dimë komunikacionin ka nevojë aty për trotuar.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Jeni nja 3 këshilltar që e keni ngritë këtë çështje. Si të vjen prej pushimit, me mbikëqyrësin e mbajmë një takim, edhe me kompanien, edhe i qesim letrat, e shifni planin dinamik edhe unë jam me juve në kuptimin edhe me qytetarët. Jo veç unë, po krejt qeveria komplet, edhe për këtë të jeni të bindur që zhvillojmë takime shumë të nxehta në salla. Atje edhe jam me këtë kemi me mbajt kur të doni, zgjedhne edhe të shtunën e mbajmë, nuk është problem.

z.Jakup Demiri: Kjo nuk është politikë te kjo pyetje që ta bëra, kjo duhet me u kry.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Edhe çështja e trotuarit edhe çështja e ujësjellësit, edhe çështja e barrojave që e ngriti këshilltari, jo pse u pajtova që nuk këna mujt me hec prej barrojave në trotuar, se nuk është qashtu, po barojat i kam pa vetë kur isha në Lubishtë, i kam thanë me i spërkat Nexhatit, e ka përmend një kompani “Zuka”. Dëgjo, këtu unë nuk po përmendi emra, mu po më interesojnë në parim me i kry detyrat edhe përgjegjësitë secila kompani që i ka, por mos harroni edhe një, ajo punë po shkon në vend, në plan, por pa ja dhënë dikasterin, pa ja dhënë detyrat, përgjegjësitë, atë paramatësin me kohë, ai nuk i kryen, prandaj kjo është institucionale kjo. Kjo çështja që e ngrit për punën e ndërtimeve, kjo është 6-mujore, duhet me u trajtu me procedurë ligjore. Shkëputja e kontratës për rrugën e Sllatinës është përmend nga 2, 3 këshilltarë, nuk është as çështje e kontratës 2-vjeçare, po me atë çmim është problemi i gjithë Kosovës, prandaj nuk kemi pas zgjidhje tjetër përveç se me ja shkëputë, se mundemi me mbet pa rrugë. Ka punu mbikëqyrësi proceduralisht ka punu zyra dhe organi kompetentë e ka shkëput.

z.Taulant Haxhiu: Cili organ e ka shkru atë.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Organi kompetentë është Kryetari, për mu nuk është me rëndësi a e ka bë pyetjen Jakupi a Taulanti, për mu jeni të barabartë krejt. Esenca është me ju përgjigj pyetjeve dhe ato çka nuk mundem me ju përgjigj unë, janë zyrtarët, drejtorët. Ato çka nuk mundemi tash, ju përgjigjemi në seancën e ardhshme. Mbikëqyrësi e ka kry detyrën e vetë, e ka qu letrën me fillu me u realizu plani dinamikë, që është bë me kompaninë implementuese. Pas marrjes së kompetencës së shpalljes së këtij fituesi, ai nuk ka vazhdu arsyetimin e ka thënë te çmimet, që në krejt Kosovën është kjo çështje dhe ne nuk kemi zgjidhje. Ne te qeveria ndikim nuk kemi me e pagu, nuk kemi ne, kemi qu vërejtje, ligjin e kemi respektu dhe kanë fillu procedurat tjera për shkëputjen e kontratës, pasi që ai është lajmru dhe vullnetarë e ka shkëputë kontratën, pasi që nuk i konvenon çmimi. Nuk është që ne nuk i bëjmë trysni. Dokumentin mundeni me marrë, po e keni edhe aty.

z.Nexhat Halili: Nëse tenderi është shkëputë, por aplikohen edhe ndëshkime: a janë apliku ato ndëshkime?

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Po janë apliku Nexhat, nëse donë qasje në dokument zyrtarë unë t'i jap. A u kry, se nuk më dëgjoje që thashë, unë nuk e realizoj. Parku i biznesit, palestrat, këto krejt janë probleme të nivelit qendror.

z.Taulant Haxhiu: Te palestra ne kemi shpenzu prej bugjetit. z.Aliu i paraqiti shpenzimet edhe tek parku i biznesit edhe tek palestra sportive jan bë 9 vjetë Kryetarë palestra sportive po zgjatet shumë duhet me ja dhën nifarë sinjali qytetareve te parku i biznesit edhe ajo me vjetë

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Ndryshon situata se te parku i biznesit është afër për miratimin e procedurës rdhyr sfrt

z.Taulant Haxhiu: 3 vite na kanë shku faza fillestare edhe 2 vite 5

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Nuk është shku 3 vite, dëgjomë 2 vite janë kanë në punë intenzive për ndërtimin e parkut të biznesit, 1 vit përgatitet plani rregullativ, janë marrë vendimet e kuvendit dhe aspektet e tjera deri sa e kemi fitu atë, u kanë edhe mobilizimi i përgjithshëm institucional të komunës në kryerjen e punës që kanë nxjerr parkun e biznesit para Komunës së Ferizajt, Gjilanit. Ky i dyti, 6-mujori nuk është formu hiq, tash kemi me trysni më shumë kemi mbajt takime me përgjegjësën që e kemi i mbikëqyrjes atje i joni po mendoj aq sa kamë kompetenca kanë bë trysni dhe kanë lëvizë ata, tash presim me fillu me përfudu këtë infrastrukturë të vogël çka ke mbet. Ne fillojmë me konkurse, nëse fillojmë me konkurse ne duhet me qenë transparentë në kuvend dhe me fillu me i thirr investitorët, e investitorë ka të interesum shumë për investitorë vitias për investitorë të mërgatës të regjionit dhe tash në këtë rast është mirë këta investitorë me i marrë më shpejtë se shpesh nuk na vinë, besoj qe me shpejt me fillu.

z.Taulant Haxhiu: A ka ndonjë afat?

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Kur të mbyllën krejt punimet dhe vazhdojnë, TV plusi është çështje procedurale dhe janë arsyet ligjore, është në të mirë të krejtve që te jemi transparentë që takëmi transmetimin në rregullt, Njësinë e Auditimit, këtë pyetje e ka pas edhe Majlinda që u përgjigja. Te bartja e mjeteve, tregova që mjetet vetanake bartën.

znj.Majlinda Shabani: Tek bartja e mjeteve, e përmende investimin, e është ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik. Në raport shkruhet në proces të realizimit 6, nuk e di çka nënkupton ajo, e dijë edhe e kuptojë që bëhet bartja e mjeteve. Nëse është projekt 2-vjeçarë në vitin 2021 kanë qenë 370 mijë, në vitin 2022 figuron 370, ku në raport të auditorit i kemi që janë shpenzu 97 mijë, dikun 600 mijë nuk muj me than projekt dyvjeçar kur nuk janë shfrytëzua paret.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Te pasqyrat financiare ta shpjegon drejtori më mirë, se nuk jemi ne ekonomista. Normalisht nuk e kupton këtë, ta shpjegon drejtori, nuk është problem. Edhe Muslia njëjtë e ka ngrit çështjen e trotuareve atje, dinamiken rrethojat e fushave nga kjo që pe përmendin këshilltarët edhe vetë po bindem që jemi tu punu shumë në teren, ishim tu punu te rrethojat te trotuaret te rrugët sinjalistikat te ndriçimi që është e vërtet është tu punu edhe në rrugët bujqësore. Dilni kqyrne rrugën e Kabashit, rrugën për Dobolde te maqina e Isakit aty, rruga te Berishtë është finalizu, ne duhet me punu më shumë ne 6-mujorin e dytë, por mos harroni se performancat më te mira i kemi ne këtë 6-mujorë, në këto 20 vitet e Vitisë i kqyrni tek pasqyrat financiare. S'e përmeni asnjë prej këshilltareve raportin e auditorit, veç 5 komuna janë, ne duhet me fol edhe atë që është e vërtet, atë që është arritje e komunës sonë, se rrjedhja e parasë se Vitisë nuk është e kualifikume, është shumë e mirë, shumë stabile për ju ekonomistit. Nexhat, e dini, e ki raportin e auditorit të vendit, kemi rekomandime të rrezikshme për shkak se është arritje e krejtve, ndoshta përmirësim po edhe diversiteti ta ndimon debati, edhe ndërhyrja e këshilltarëve që folin pa renë, unë jam shumë mirënjohës gjithmonë. Ne i bëjmë planet e zbatimit, rekomandimit, zhvillimit te kuvendit dhe të auditorit, ne kemi bë planë të veprimtimit edhe të auditorit për këto që janë të pakualifikum për shkak se ato na nevojiten me i përmirësu. Kemi USAID-in,

prandaj merrne kqyrne auditorin që e përmëna jo rasisht kemi punu më shumë si Komunë e Vitisë në raport me komunat e tjera. Qe ku e ki Gjilanin, Ferizajn, Prishtinën, komuna më e dalluara jemi ne. Ka pyetje për drejtorit veç e veç, ka për arsimin, ka për prokurimin, ka për inxhiniera. Te inxhinierat, pasi që nuk është Xhelali, se Rafizi ka qenë aty, u befasova Nexhat pak me ty, kështu po ta them miqësisht, ti duhesh me ditë se këtë punë e ke punu. The se, pse Zyra e Projekteve me u përzi te hartimi i projekteve. A e din pse, se kush ia jep temat e referencës kompanisë që t'i bënë projektet, projektet për investime kapitale planifikohen, kuvendi i miraton, qeveria i propozon, po mandej si implementohen.

z.Nexhat Halili: Pse Kryetarë 570 mi euro ke nënshkru kontratë.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Tash ta shpjegojnë zyrtarët më mirë po edhe un po ta shpjegoj.

z.Nexhat Halili: Zyra e Projektit duhet të paktën me mbikëqyrë atë projekt kur të përgatitet projekti të cilën e keni lidhë për hartim të projektit, mirëpo keni lidhë kontratë 570 mijë, nuk e ka në atë çështje pse bash zyra, mirëpo kur e ki kontratën me zyrën e projekteve ose mos e lidhë hiq kontratën.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Këto janë shërbime që blihen, nuk do me thënë me i hargjit 400 mijë euro. Nëse ty nuk të vyn 400 mijë euro, nëse të vyen, përshebull ti i nxjerr 10 milion euro projekt. Shembull pe marrim nëse ty të vyn spërkatja e barojave dhe ki firmën e referencës atje në paramas për spërkatjen e barojave nëse ke shti ke qenë i kujdesshëm edhe ki buxhet te planifikum, mundësh me i qu me ti ndreqë nëse ki kontratë të rregullt. Kjo është efikasiteti nga saktësia. Shembull as ti se ke ditë as un nuk e kam dit që un e fitoj grandin e performancës 374 mi euro, tash e kam fitu dhe orientimi është fleksibil dhe ti tash vendos ku me i qu projektet ku të nevojitet, ku ki deficide, kush ta bënë projektin i ideor dhe sa kushton projekti detal. A dinë ti duhet me nda buxhet për shërbimet qe ki mi ble për gjërat që ki mi shpenzu, gjërat që te nevojiten, që ki mi plotësu dhe duhesh me ditë ku e ki territorin tanë. Unë për shembull e dijë, nuk bazona vetëm në kornizën e projekteve kapitale dhe e dijë sa projekte ka mi përpilu, prandaj unë duhet me pas kujdes me Zyrën e Planifikimit, me Zyrën e Prokurimit edhe me planifiku buxhetin dhe projektin. Unë nuk merrna me paramatëse dhe parallogari dhe me çmim, se çmimi është nga kompania që i ke blejë shpenzimet dhe aty i ki për kanalizim, kaq për trotuare, kaq për asfalt, kaq për sinjalistikë, kaq, se janë të procedume. Po dikush duhet me u kujdes, kjo është progresi komunal, për këtë kemi performancë të auditorit, se rrjedhja e parasë, zotimet, planifikimet janë edhe të Zyrës së Prokurimit, se ne zhvillojmë debat me drejtorat sikur këtu qe po bisedojmë për secilën lami edhe në komunitet që na ndihmon në saktësi. Ne duhet me planifiku buxhetin me i projektu projektet me i implementu, me i qit në procedurë. Ne krejt jemi tu i bë, OSHP-ja po na i nal edhe krejt Kosovën e kanë blloku edhe nuk ka qarkullim të parasë, nuk ka punë, nuk ka infrastrukturë, nuk jemi tu e pa se çka është ka bëhet. Shkolla e muzikës. Nuk kemi pretendime për shkollën e muzikës, kemi për filiale, për klasë, për bashkëpunim kam fol me kryetarin e Gjilanit, ka qenë dhe ka thënë shumë shpejtë do ta bëjmë për shkollë të muzikës një marrëveshje bilaterale për te dy komunat. Unë kam fol edhe personalisht, kem qenë bashkë, nuk e di a i kam mbet ndokujt borxh për përgjigje. Dhe tjetra, gjithmonë me punu bashkë është më mirë. Zyrtarët të cilët kanë me u përgjigj ne të përgjigjen kryesues, se këtu po thonë që shkollat nuk kanë material, më së pari në Drobesh. Dallimi mes shkollës është sikur nata me ditë, është bë shkollë europiane.

znj.Fatbardha Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht më lejoni të ju falënderoj për disa shqetësime e disa pyetje, interesi është i përbashkët. Majlinda pyeti në lidhje me raportin 6-mujor transportin të nxënësve dhe ku ju e dini që arsimit fillor është obligativ dhe në ato lokalitete ku nuk ofrohet niveli arsimor në Letnicë, ofrohet nga 1 deri në 5, ndërsa nga klasa e 6 deri në klasën e 9 nga drejtoria arsimit

organizohet transporti në shkollën, Stubell, gjithashtu edhe Potgorci 6 deri në 9 shkojnë në shkollën e Ramnishtës, po kjo është një kontratë publike që është e nënshkrime nga Zyra e Prokurimit, tani jemi në fazën e planifikimit edhe për vitin e ardhshëm shkollor për mbështetjen e këtyre nxënësve për transportin. Tek vlera gjithashtu e gjeni te pasqyra financiare, aty është obligime dhe pagesa që është organizu. Musliu e ngriti një çështje që konsideroj që për vitin e ri shkollor duhet të jetë pjesë jo vetëm kjo po edhe çështje tjera që janë disiplinë edhe e shkollave dhe e nxënësve. Konsideroj që është një temë jashtëzakonisht me vend, që mos të pengohet procesi mësimor me organizimin e ditëlindjeve edhe çështjeve tjera, por nuk besoj që është pengu procesi mësimor. Gjithë ky organizim është zhvillu në fund të procesit mësimor, por ndoshta qytetarët mundën me keqkuptu, mendojnë që është humbë një orë mësimore për shkak të ditëlindjes apo pensionimit. Asnjëherë nuk është pengu mësimi në këto ngjarje. U ngrit edhe një pyetje për ndërtimin e çerdhes së re. Ju e dini që ministritë e linjës edhe komuna, organizatat buxhetore, planifikimin nuk e bëjnë vetëm për 1 vit, por për 3 vite buxhetore edhe ne si drejtori e arsimit vazhdimisht kemi bërë kërkesa për ndërtimin e çerdheve të reja, pasi që nuk i plotësojnë nevojat. Në këtë sektor për vitin 2022 ka qenë planifikimi i ndërtimit të çerdhes në Komunën e Vitisë, që konsideroj është prapë, sepse është në sistem dhe ministria ka kërku nga ne që ne të ndajmë një lokacion. E kemi pru kërkesën këtu dhe ju e keni miratu propozim vendimin tonë për caktim të lokacionit. Ne e kemi kompletu dosjen dhe ministria me datën 27 maj është dalë shpallja e tenderit publik. Një njoftim të tillë e keni parë në faqen e ministrisë, që ne ju kemi gëzu dhe e kemi përshëndet, ndërsa masë 5, 6 jave është anulë pa ndonjë arsye edhe është rishpall dhe nuk është çerdhja në Viti po është zëvendësu çerdhja në Koretin të Kamenicës. Unë kam shku në ministri, kam dërgu 2-3 shkresa, zyrtarisht nuk kam asnjë informatë. Unë pres me shpresë që do të rishpallet edhe Vitia shumë shpejtë, për shkak se është në pjesën e planifikimit. Nuk du me mëndu që është politike kjo, sepse buxheti për ndërtimin e çerdheve në Ministrinë e Arsimit është jashtëzakonisht i madh, jo vetëm për një çerdhe, po Ministria e Arsimit ka buxhet me i ndërtu edhe 15 çerdhe të tjera. Jam e bindur që shumë shpejt ka me e rishapall tenderin për ndërtimin e çerdhes në Viti, sepse Komuna e Vitisë është njëra ndër komunat qe ka nevojë më së shumti për çerdhe. Buxheti është 850 mijë euro dhe si komunë që jemi, nuk kemi mundësi buxhetore me ndërtu një çerdhe të këtij kapaciteti. Kështu që, kërkojë edhe nga grupi i këshilltarëve të Vetëvendosjes, me që partia në pushtet në nivel qendrorë është e Vetëvendosjes, të trokasin dhe të ju tregojnë se, Komuna e Vitisë ka nevojë, dhe të mos shkojnë investimet vetëm në komunat ku qeverisë partia që udhëheq qeverinë, po buxheti të ndahet në mënyrë proporcionale. Ne e dimë krejt që buxheti është i nevojave qytetare, po e kemi pa shumë herë që, buxhetet janë edhe politike. Nuk po du me dhanë këtë përshtypje, sepse po presë që shumë shpejt ka mu riprocedu rishpallja e çerdhes së re ne Viti. Mbetemi me shpresë, sepse ne edhe qarkoren e parë buxhetore e kemi planifiku numrin e stafit të edukatoreve. E keni pa kur ju ka ardh qarkorja buxhetore që është rritë për 11. Tek hartimi parafillor, pikërisht tu e pa që ka me u ndërtu edhe një çerdhe, kemi planifiku edhe mirëmbajtës edhe kuzhinierë edhe të gjitha këto. Tani e kemi pa shpalljen për fëmijë në çerdhe, aq shumë ka kërkesa saqë janë të pamundura me i përfshi kjo çerdhja që është momentale dhe paralelja ne Qifllak. Kështu, sa i përket investimeve, këtu duhet të jemi të njëzëri kuvendë-qeveri-opozitë-pozitë kur të është interesi i përbashkët, e aq më pakë ku janë mosha e 5-6 vjeçe, që është e pa arsyeshme me u dëmtu në këtë masë. Sa i përket shkollës së muzikës u përgjigj kryetari. Sejda e ngriti edhe çështje e 5 psikologëve në shkollat e Komunës së Vitisë. Nuk janë vetëm 5 psikologë që do të angazhohen nga viti i ri shkollorë, janë edhe 4 të tjerë që i kemi marrë në mandatin e kaluar që kam qenë drejtoreshë. Tani janë edhe 5 ku bëjnë përpjekje në ato orë mësimore kur janë të panevojshme me e konvertu në staf të nevojshëm siç është

rasti i psikologëve tani i kemi 5 pozita, i kemi dërgu në Zyrën e Personelit që kanë fillu me procedurat e konkursit publik. Shkolla që do të ketë psikolog, natyrisht është numri mbi 500 nxënës edhe pse udhëzimi administrativë thotë 1 mijë, po tu e pa nevojën që duhet me u ndryshu ajo, po bëjmë përpjeke që të gjitha shkollat që kanë mbi 500 nxënës të ketë shërbime psikologjike. Një psikolog mundë t'i shërbejë 1 shkolle, 2 shkolla apo më tutje. Po ashtu edhe si staf mbështetës për vlerësimin e fëmije me nevojat e veçanta, ekipa komunale ka vlerësu që, më së shumti kanë nevojë për mësues mbështetës se për asistentë. Me që është raporti 6-mujor aty, i keni pa të gjitha investimet që i kemi bë, edhe jemi duke punu në fillimin e vitit të ri shkollor, në mënyrën më të mirë të mundshme viti i kaluar shkollorë është përfundu në mënyrën më të mirë edhe në testin e maturës ku mbi 81% e nxënësve maturant kanë kalu testin e maturës edhe rezultatet e rigjistrimit në afatin e parë. Janë të kënaqshëm edhe pse fillimi ka qenë me pandemi po shifet se ka qenë një përkushtim i dy anshëm nxënësë mësimdhënës për me zhvillu procesin arsimor. Po ashtu edhe sa i përket furnizimit të materialeve që i kanë kërku shkollat në ato kontrata, që është kompetentë Komuna e Vitisë. Ne vazhdimisht kemi qenë të përgjegjshëm, ka kontrata që menaxhohen nga niveli qendrorë e përmendët kopjet në fillimin e kësaj seance sa për informimin e juve. Kjo kontratë menaxhohet nga AQP-ja dhe është sfida më e madhe jo vetëm në shkolla po edhe në komuna në administratën komunale shërbimi i printimit edhe nuk është që ne si institucione nuk po dojmë me ofru po është një kontratë e lidhur me AQK-në që i shërben gjitha institucioneve, komunave, tash në shkollë atje në Lubishtë me shku me pritë deri sa të vije në shërbim prej Prishtinës. Këtë e konsiderojë që është e teprume. Kaq kisha, faleminderit shumë!

z.Skenderbe Hebibi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Çështja e gjeneratorit. Kur e kemi fillu drejtorinë, ka qenë sfidë, domethënë nuk kemi pas gjenerator te objekti i ri. Ne kemi marrë masa me kryetarin, që me fillu diçka, me bë në lidhje me atë drejtim e kemi marrë një gjeneratorë te kadastra e vjetër po nuk i plotëson kushtet ne i kemi shiku mundësitë për me blejë një gjeneratorë të ri edhe për këtë arsye nuk kemi mundësi me kry me te hyrat qe i kemi ne kuadër të administratës është edhe tatimit në pronë, është edhe kadastra janë 3 organe që japin drejtë për së drejti këtë dokumentacion për qytetarët andaj jemi tu merr me këtë problem, po procedurat janë pak edhe të zhagitshme edhe të mundimshe nuk e kemi lënë në asgjë. Shpresojmë që afatin sa më të shpejtë ta marrim një gjenerator të ri që plotëson kushtet për krejt objektin e ri të administratës për objektin e vjetër të administratës, gjeneratori është.

z.Naim Pira: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! znj.Majlinda ngriti një pyetje apo shqetësim si ta quaj, në çështjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, dëshirojë të ju informojë se Drejtoria e Bujqësisë, në momentin e marrjes së mandatit ka pas parasysh pjesën e subvencioneve të cilët janë përcaktuar me buxhet të kuvendit komunal, janë bërë përgatitjet me kohë. Në këtë aspekt, në fazën e parë na kanë dështu 2 projekte, 1 për faktin se OSHP-ja ka qenë jo funksionale, dhe thirrja që ka qenë për furnizim i ka kalu afati dhe e kemi ndalë dhe 1 ka dështu në aspektin e arrave që ska pasë të interesum, janë shpenzu deri tashë 42 mijë e 560 euro në procedurë të thirrjes, planifikohen 4 projekte që do të ketë 100 mijë euro deri në fund të vitit. Konsideroj që do të jetë vit rekord, sepse janë 500 bujq. Kur e kemi ne listën që kanë apliku për subvencione, konsideroj se është sukses. Besoj që nuk jemi vonu dhe nuk do të vonohemi për shkak të procedurave dhe mos harroni se, mekanizmi i cili jepet për bujqësi, nuk jepet vetëm për 6-mujorshin e parë. Nëse këtë për bazë e marrim parasysh faktin që subvencionet jepen për të mbjellat e grurit për këtë vit, domethënë janë mbjellë në tetor dhe akoma nuk është në rendë, dhe sigurisht duhet të ndodhin edhe mbjelljet e këtij viti në tetor dhe sigurisht do t'i marrin.

Ju garantojë që do të ketë subvencione, punë është tu bë, megjithatë shqetësimet janë gjithmonë të mirëseardhura në përmasimin e procesit.

znj.Merrushe Ahmeti: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Atëherë sa i përket pyetjes se zotërisë, se pse nuk ka barnatore në viti 24 orë në Viti, ne kemi bë kërkesë te Drejtoria e Inspektoratit, mirëpo si drejtori e inspektoratit nuk ka të drejtë legjitime për urdhër obligim patjetër me pas, megjithatë ne do të shikojmë mundësinë me bë një marrëveshje me barnatore të cilat janë në Viti, në mënyrë që edhe ato me qenë të pajtimit. Ne nuk kemi kompetenca ligjore për obligim, që me qenë barnatore 24 orëshe, megjithatë kemi me kriju mënyra për me qenë një barnatore 24 orëshe.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ky shqetësim ka qenë që përherë, e kemi diskutu tu e marrë parasysh që barnatoret janë biznese private, mirëpo kemi insistu edhe ne kemi kërku që, në bisedime me barnatore sikur në Gjilan si e kanë ata, merren veshë dhe punojnë me renë në ndërrime të natës.

znj.Liridona Bislimi: Temë diskutimi duhet me bë diku tjetër, por meqenëse kryetari vetë e hapi temën, mu dok mu drejtove mu apo?

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti: Nëse je pjesë e asaj.

znj.Liridona Bislimi: Ti aludove.

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti: Po a je pjesë?

znj.Liridona Bislimi: Ti e përdore kuvendin komunal. Kryetar, sa për informacion gjatë kohës së fushatës së zgjedhjeve lokale, kanë ekzistë diku mbi 20 faqe me emrin Viti. Çka po di.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Denigruese a?

znj.Liridona Bislimi: Denigruese kundër Lëvizjes Vetëvendosje kundër anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe çka është më së interesante, nuk të ndërpreva aspak, çka është me interesante kanë qenë hapur me numra personal. Kanë qenë të hapur me lokacione që kanë harru me i ndalë, e kush i udhëheq ato faqe, e ke dit ti i nderuar, nëse ki diçka kundër, nuk është në rregull me e diskutu në sheshet e Vitisë me me qu selame mu ti, nëse nuk me nje ti e ke taku prindin temë shumë herë gjatë mandatit të kaluar kur ke pas nevojë diçka në kuvend, e që normalisht nuk ke përfitu kurgja hiq ti. E njëf nanën temë te dashur koleg, unë nanën e kam të Lubishtes, jam mes e Lubishtes dhe jam shumë krenare për dajtë e mi. Nëse ke diçka kundër lubishtanve e që me ke qu selam, e ki than ajo bija e shkinës, po merret me web faqe, atëherë ti shko mirru me njerëz te Lubishtes, nuk është nevoja ti përmes kuvendit komunal me hapë këtë diskutim. Edhe në mandatin e kaluar ka ndodhe rasti i njëjtë ndaj një kolegut që ka alodu kështu. Nëse ke dyshime diçka ne mua janë institucionet.

z.Basri Sylejmani: Edhe unë kam ndaj saj, se edhe për mu kanë shkru, nuk kanë shkru veç për kryetarin, kanë shkru edhe për mu 4-5 herë. Në qoftëse është, në të jetë në nderin e saj. Ti më ke thanë që jo, po në qoftëse e ke shkru me grupin tanë, ne të jetë nderi yt.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk ka ndërgjegje më te rëndë se sa me shkru msheftë, e sa me sha msheftë, e sa me shpikë msheftë e sa me na etiketu msheftë se të jeni të bindur me rand e kemi pas ne që kemi qenë në kryesi edhe pse ndoshta kam qenë më pakë por megjithatë ne kemi qenë më shumë se krejt ju është më e rënda kur të shkruhet e nuk e di se kush po shkrun, se ai që ka pak karakter e njerzillakë del me emër të vetë shkrun, me emer te vetë edhe del ballafaqohesh me atë. Këto çështje janë çështje të ulëta. Ju kisha lutë që këto çështje mos me u bë ne kuvendë, se ne jemi për çështje më të larta, duhet me u kanë shembull për qytetarët. Për këtë arsye duhet me i sqaru këto çështje përmes organeve.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Kryesues, bash thirrja jeme ke bashë personale ke. Mos e merr demokracinë në Kuvendë të Vitisë, se qe 20 vite është rujt edhe ju thash mos ja bani qysh ja keni bënë, dëgjo, se normal që e dinë organet dhe i kanë zbulu shumë normale, se ajo ka kriju **amulli** 1 javë, 1 muaj, po normal që del e tash ju thashë mos e bini këtë fjalorë në Kuvend, se u nis te fjala jote edhe e jote, ti e di çka thave sot, kur ta thuash atë fjali duhesh me ditë. Nëse mendon ti se denigron, këtu në kuvend hajt se kurgja, edhe fyen, edhe ai djali, a pe shef ti s'je distancu kryesues prej atyre a pe shef se tu ka ripërtëritë ajo dhe ti s'je distancu as grupi parlamentarë. Jakupi i VV-së nuk është distancu prej qati fjalori. Kush e kqyrë fjalorin e atij zotërisë që thotë, a më ke qu në gjykatë sot a e nise, a unë e iniciova, kjo tha qashtu qysh tha, unë thashë ai fjalor nuk është përdor qetu as ndaj Musa Misini, as ndaj Nexhmedin Arifit, as ndaj Samet Dalipit, as te Daut Xhemajli. Këtë fjalor ju e keni importu në kuvend, mu nuk më pengon Taulanti që është pozitivë e u sill si opozitivë. Sot foli si shef i grupit parlamentar dhe foli si opozitivë. Faktikisht nuk më pengon se nuk më pengon diversiteti.

z.Taulant Haxhiu: Taulanti i ka përgjegjësitë e veta, Taulanti tha gjithçka në interes të qytetarëve, Taulanti thotë çka mendon edhe e lirinë e Taulantit të shprehjes nuk ka fuqi në këtë botë me ndryshu. Taulant Haxhiu është Taulant Haxhiu, të lutna emrin tem mos ma përmend.

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti: Jo ta përmendi emrin normalisht sikur që ma përmendi ti mu emrin.

z.Taulant Haxhiu: Taulant Haxhiu është i pa lëkundur.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Edhe njëherë po e përsëris, nuk më pengon qëndrimi i diversitetit sikur i Taulantit i cili është pozitivë a foli si opozitar, nuk më pengojë, më pengon qekjo fjala jote që ke fyese, denigruese. Një fjali e ke thanë sot, krejt të kam ndëgju dhe ajo që e përmendi ajo na kthejë në seancën e parë, a unë dje kam pas trysni dhe probleme me legjitimitetin e juve, më kanë ardh në zyre më kanë thanë që nuk janë legjitim pse i ke pranë në Kuvend. Shikone fjalorin tënd demokratik. Unë po ju kallëzoj, ti një here, unë jam tri here, kam kulturë demokratike. Fjali mos më nxerrni ma palidhje kurr hiq.

Znj.Liridona Bislimi: Ne ta gjenë një kryetar komune që ka vepru njëjtë si ka vepru ky në raport me mu, veç ma tregoni një kryetar.

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti: Shko kallëzoj atij shokit tanë të Smirës, t'i dëgjo pakë edhe atij të Kabashit, atij të Sllatinës për web-faqet edhe ne kena njeri dëshmitar këtu, këshilltarë që kanë shkru. Dëgjomë veq pak, po e qitni vet debatin jashtë asaj tani po thuni mu.

znj.Liridona Bislimi: Pse nuk ke shku në polici nëse ki dyshime në raport me mu.

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti: Mos e ki problem se, policia është tu u marrë me këtë punë.

z.Jakup Demiri: Qekjo farë tema që po diskutohen qëto fjalë qetu, ti e qele këtë temë, se di a e ki me qellim a pa qellim. Fillimisht banëm pyetje përgjigje, pastaj raportin, tanë unë bëra pyetje, por nuk morra përgjigje te ujësjellësi dhe te ndriçimi publik. Qëllimi i kësaj mbledhje po dihet, qekjo është.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: Te ndriçimi publik kemi parapemtra, planifikim, kemi me hecë në implementim, projektet janë në OSHP. OSHP-ja nuk ka punu në këtë drejtim që gjashtë muaj, dihet pse. Ujësjellësi i Verbanit edhe i Smirës ka shku kadale, po çështja ka qenë e keqe edhe në implementim. Tashë sa ka mrri fshati në kyqje si nënshkruet i memorandumit në Smirë nuk e di, unë e di që është shumë afër ai ujësjellës ka me u kyq në ujësjellësin e Letnicës.

z.Nexhat Halili: Unë po shohë këtu që po aludojnë OSHP për projektin. Projekti Viti-Kerbliq nuk ka pas bord të OSHP-së kur është nënshkru kontrata, edhe këto tjerat keni mujt me i përfundu, e keni rastin e rrugës Sllatinë -Viti, 152 mijë euro. Në seancën e 3, 4 i keni bartë për çdo ditë, po ju jeni detyru me ndërpre kontratën

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti: Po jemi detyru me ligj.

z.Ilir Zuka: E ka diskutu 6 muaj punën e ujësjellësit, sot Pozherani nuk ka ujësjellës tu e keqpërdorë banorët banoret e Trestenikut, e dimi me emër e mbiemër kush po e keq përdor ujin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk keni nevojë me bë shumë debat, janë inspeksioni, uji duhet të hy në menagjim të "Hidromoraves". Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë pikë të rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3.Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar - Qershor 2022

z.Besnik Imeri Drejtori I financave: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet të tjera në fuqi, para jush dua të paraqes pasqyrat 6-mujore financiare gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 janë inkasuar gjithsej të hyra vetanake në vlerë prej 448 mijë e 843 euro e 88 cent, duke u bazuar në planifikimin vjetor. Kjo vlerë është me përqindje 45.13%, ndërsa me krahasu me të hyrat në periudhën Janar-Qershor 2021, të hyrat në 2022 janë më të ulëta për 50 mijë e 320 euro e 50 cent. Buxheti i alukuar për periudhën Janar-Qershor 2022 nga fondet burimore, grandit qeveritarë e të hyrat vetanake dhe donatorët janë 7 milion e 79 mijë e 287.75 cent, ndërsa shpenzimet janë 6 milion e 46 mijë e 555 euro e 74 cent. Shkalla e ekzekutivit të buxhetit për këtë periudhë është 45.41% në krahasim me alukimet për të gjitha kategoritë ekonomike. Kontratat në vazhdim në kategorinë ekonomike, paga dhe shtesa, totali i shpenzimeve është 3 milion e 940 mijë e 460 euro 90 centë apo ekzekutimi është 99.32% mallra dhe shërbime 771mi e 1 euro e 95 cent apo 75.02%, komunal 134 mijë 851 euro .42 cent apo 77.28%, subvencione 133 mijë e 29 euro apo 83.95%, investime kapitale 1 milion e 63 mijë e 212 euro e 47 cent apo 61.05%. Përqindja mesatare është 85.41%, totali i aprovimeve për këtë vit është 13 milion e 348 mijë e 532 euro e 63 cent, totali i alukimeve është 7 milion e 79 mijë e 287 euro e 75 cent dhe totali i shpenzimeve, ekzekutimi i buxhetit që thashë edhe më përpara, është 6 milion e 46 mijë e 555 euro e 74 cent. Në faqen 19, janë të paraqitura të hyrat vetanake të planifikuara, të realizuara për periudhën janar qershor, gjithashtu e kemi edhe diferencën në planin vjetor dhe diferencën e planit 6-mujor. Vlen të ceket që tatimi në pronë është 22 mijë euro më pakë me arsyetu, prapë ju e dini për cilat arsye është kanë më i vogël inkasomi, por kemi prit që kemi me pas më pak inkasim, mirëpo vetëdijesimi i qytetareve ka bë që të jetë inkasimi në këtë nivel. Kemi të hyrat nga donacionet prej 219 mijë e 130 euro e 89 cent nga fondi Demos-Elvetas si dhe nga grandit i performancës. Gjithashtu kam marrë pyetje në KPF që pse në vitin 2021 nuk ka pas domethënë vetëm 6-mujor nuk ka pas të hyra nga donacioni në vitin 2021. Në total nga ekzekutimi i buxhetit në pjesën e investimeve kapitale si e thashë kemi 1 milion e 63 mijë e 212 euro e 47 cent. Nga këto, 352 mijë janë pagesa për vitin e kaluar të cilët për projektet të cilat nuk kanë pas pranim teknik. Në faqen 24 e kemi prezantimin e investimeve në mënyrë grafike. Grandit qeveritar merr pjesë në këto investime në 95.62% të hyrat vetanake, 4.38% u mundova që sa më shkurt të bëj prezantimin shëfave të grupeve dhe asamblistes Liridones për Vetvendosjes, ja kam dhanë shpjegimin për kodet të cilat pyetje bëhen shpejtë, z.Ali dhe z.Taulant, ja u dërgova tash, aty i keni shpjegimet për kodet e përgjithshme, për pyetjet shpesh jam në dispozicionin e juaj.

z.Ali Bajrami: Faleminderit kryesues, faleminderit drejtorit për shpjegimin të pasqyrave financiare Janar Qershor 2022, nuk po i hi me shifra, se drejtori sapo i shpjegoj, është një buxhet që është i shpenzum për këtë vit, çka na mbetet për 6-mujorin e dytë, na mbetet që të kemi një angazhim më të madh, ta rrisim angazhimin dhe potencialin që ta rrisim grumbullimin e të hyrave vetanake që të bëjmë investime aty ku ka nevojë komuna. Nëse i shohim shpenzimet e zyrës se Kryetarit edhe te drejtoritë në përjashtim të drejtorisë së financave që kemi

shpenzimet më të ulëta po dihet se zakonisht në tremujorin e 3 dhe të 4 në drejtorin e financave mjetet e orientime shpenzohen më tepër që janë të caktume dhe të parapamë te drejtoritë tjera buxheti është shpenzu tu fillu nga zyra e kryetarit me 90% ajo që duhet bëjmë përpjekje sikurë në 3 mujorin e 3 që të angazhohemi në investime e mjeteve të parapamë për projektin e investimeve kapitale që ato qka i kemi të destinume të i shpenzojmë e jo të na bartën për vitin e ardhshëm ky buxhet është a është mjaftë nuk është a ka nevojë komuna për më shumë ka nevojë po kjo është ajo që na takon si komunë, ajo çka mujmë më rritë është që ta rrisim angazhimin politikë grumbullimin e të hyrave vetanake t'i shpenzojmë ashtu si është më së miri konfrom ligjeve dhe t'i investojmë aty ku ka nevojë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne e dimë që raporti i financave paraqet çdo shpenzim apo pagesë që është bë te të gjitha drejtoritë për 6 muaj.

z.Nexhat Halili: Gjatë analizës të kësaj pasqyrës financiare për 6-mujorin e 2022, buxheti ka qenë diku 13 milion e 348 mijë 531 euro të aprovume, ndërsa alukimet janë 7 milion e 79, të paalukuara janë 269 248 tek shpenzimet shihen se pagat dhe shtesat mallrat dhe shërbimet te komunalit dhe subvencionet nuk janë keq mirëpo bregosese te investimet kapitale investimet kapitale janë diku për 61.5%, duke i analizu shpenzimet e këtij 6 mujori shihet se tek fondi ekonomikë pagesat për obligimet gjyqësore është një rritje. Nga ka ardh kjo rritje dhe pse. Në bazë të llogaritjeve të shpenzimeve edhe shpenzimet e rrymës kanë rritje mos me hy në të gjitha se shihet edhe në bazë të kësaj pasqyre, mirëpo aty ku janë ngritjet më të larta janë më bregosese, shërbimet e ndryshme shëndetësore kanë rritje 24 mijë e 742 në krahasim me vitin 2022 me 2021. Kemi rritje edhe te shërbimet tjera kontraktuese, është mirë t'i specifikojmë pak më detalisht, kemi rritje edhe te mobilet, tash nuk e di pse ka ardh deri te kjo rritje në këtë vlerë, ku në vitin 2021 kanë qenë 400 euro, tash janë 31 mijë e 479 euro. A janë këto të vitit të kalum që janë bartë këtë vit e që e kanë rritë këtë vlerë? Tash ke rritje edhe te pajisjet e trafikut. Te hapja e rrugëve lokale në vitin 2021 kanë qenë 76 mijë e 180 euro shpenzime, ndërsa tash janë 180 mijë e 885 euro. Ka kanë ardh këto shpenzime? A janë të këtij viti apo të vitit të kalum? Se këto tash po lidhet gjithçka me kontratat 2-vjeçare. E kemi rastin edhe te mirëmbajtja e ndërtesave, kemi diku 21 mijë 762 euro rritje është marr naj objekt me qera apo është ndërtu ndonjë objekt që ne nuk po e dimë pse është be kjo rritje në mirëmbajtjen e ndërtesave. Kemi rritje edhe të tjera në bazë të kësaj çka sho këtu në bazë të të gjitha drejtorive duke e përfshi edhe kryetarin e komunës, përveç Drejtorisë së Kadastrës edhe Drejtorisë së Shëndetësisë të cilët nuk kanë rritje të tjerat të gjitha kanë rritje të shpenzimeve, edhe diçka që du me e laburu tek investimet kapitale. Me sa shohë unë tash gati se shumica e investimeve kapitale të cilat janë paraqitë në këtë tabelë, më duket mua sikur janë bartë prej vitit të kalum në këtë vit, në përjashtim të 2,3 projekteve që janë të këtij viti.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje i nderuari drejtor! Unë para se me i specifiku këto shifra. Deshta me ditë një informatë, vendimet e gjykatave për kontratat kolektive të mësimdhënësve. Sa është shuma për këtë vit si informatë? Edhe qeto prezantimet të investimeve në periudhën Janar-Qershor 2022 janë 1 milion e 63 mijë e 212 euro e 45 cent. Sa janë të pagume në vitin 2021 që janë bartë në vitin 2022, sa është vlere? Në faqen 23 kemi te krahasimet e shpenzimeve në vitin 2022 në të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi shpenzime të ndryshme shëndetësore 92 mijë, me 170 mijë, 24 mijë kemi sivjet më shumë, po prapë kemi furnizime mjekësore 2 mijë e 900 e 31. Domethënë edhe ato 28 mijë, 24 edhe 28 veç për mjekësi kanë shku për shërbime dhe furnizime janë 52 mijë euro më shumë se vitin e kaluar. Te shërbimet kontraktuese edhe në seancën e kaluar, edhe kolegu im pak më herët e tha, është mirë me specifiku se çka do të thotë shërbimet tjera kontraktuese. Nuk e dinë as

qytetarët as ne. Kemi 41 mijë në vitin e kaluar, sivjet kemi 83 mijë 006, domethënë rritja e shpenzimeve dikun është 96% me vitin paraprak. Është mirë me ditë çka është kjo rritje e madhe kontraktuese. Kemi mobilje prej 400 euro për vitin paraprak, kemi këtë vit dikun 31 mijë e 479, që është një vlerë jashtëzakonisht e madhe. Unë nuk e di sa zyre janë mobilu, çfarë mobile janë kanë, të argjendit apo të alltanit, se vlera është jashtëzakonisht e madhe me pa një qytetarë i komunës tonë 400 me 31 mi është marramendëse, po në qofte se ka shpjegime është e arsyeshme. Te furnizimet për zyre prej 17 mijë e 317 kemi 21 mijë e 662, kemi diku 25% ngritje. Dhe pajisjet tjera, prapë është diçka që ne nuk e dimë prej 34 në 48, do të thotë 42%. Kemi ngritje te shpenzimet për pajisjet tjera. Këto që ti thashë janë me rëndësi për qytetarin është mirë me i sqaru sot ose në seancën tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kemi diskutu edhe në komitet, se te tabela e fundit e faqes 26, më herët folëm me drejtorin, e kemi pas një rubrikë se aty kanë hi shpenzimet ose pagesat e bartura të vitit të kalum që janë bartë në këtë 6-mujor edhe e kemi pas një raport një koordinim më të mirë. Përshembull sa ka pas pagesa të vitit paraprak. Sivjet atë tabelë e kemi përfshi në raport, kjo është me e arsyeshme që me pa këtë shpenzim. Domethënë na ka mungu për me bë këtë arsyetim që ne me kuptu drejtpërsëdrejti pa e bë këtë shpjegim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Këto po përsëritet sa herë në çdo seancë. Domethënë kur është fjala për pasqyrat financiare, shumica e këshilltarëve ndoshta që edhe i dinë çka janë, por megjithatë ata kanë të drejtë me pyet kanë një prej saj tha çka është... po e merr fjalën drejtori.

z.Besnik Imeri Drejtori I financave: Për atë arsye shpjegimin e kodëve të përgjithshme ja u dhashë shfave të grupëve

z.Taulant Haxhiu: Vendimet e gjykatave për kontrata kolektive të mësimdhënësve, nëse kë mundësi me ditë?

z.Besnik Imeri Drejtori I financave: Për shefin e grupit të PDK-së, për këtë arsye që ka rritje të kapitalit në këtë 6-mujor kemi rritje të ekzekutimit të buxhetit në mes të hyrave te investimet kapitale për 192 mijë euro pak mbi këtë vlerë siç e dimë se kjo rritje ekonomike kur ka kriza shteti duhet me nda prej mjeteve në tregë jo me I importu te tatimi në pronë. Njëri ka thënë të krijojmë zgjidhje, po presim tash për kontratën e televizionit me kënd do të bëhet edhe me fillu sensibilizimi për tatimin në pronë. Gjithashtu edhe një ekip është e koordine me nënkryetarin, një ekip është për teren, sidomos derë për dere për borxhilitë e mëdhenj me fillu me përmbaues me shku te masa më e ashpër me shku me sensibilizim, pasi me këtë ata edhe I mësojnë. Gjithashtu shumica e pyetjeve Nexhat kenë ne lidhje me këtë shkrim që ja kam dhanë Liridonës, shpjegimi I kodeve të përgjithshme, ndërsa te mobilet hynë edhe të gjitha furnizimet shkollave, nuk munden me kanë furnizime për zyre të administratës, si e kemi bisedu edhe në KPF, me pas edhe një kolon të veçantë për shpenzimet që janë bartë prej vitit të kalum në këtë vit, edhe që I kemi pagu të vitit paraprakë. Gjithashtu Taulant për vitin e kaluar e kemi thirr kapitalin e shkallës së prezantimeve, investimeve për vitin e kalum 352 mijë e 807 euro e 62 centë. Janë pa pagu fakturatë e vitit të kaluar. Prapë po themë, për korrektimin e pasqyrave financiare, e marrë përgjegjësinë unë, ndërsa për kategorinë ekonomike, secila drejtori e ka furnizuesin e buxhetit të tij, edhe e di saktë çka ka shpenzime, si ka ndodhë, pse ka ndodhë ose pse nuk ka ndodhë.

z.Taulant Haxhiu: Furnizime shëndetësore edhe shërbime shëndetësore, a bën këtë me ma sqaru?

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Qaty e ki Taulant, kodi 13430 e ki shërbime të ndryshme shëndetësore, i ki 117 mijë, këtu e ki domethënë kontratën me Karitas.

z.Taulant Haxhiu: Furnizimi mjekësorë i barnave në faqen e 2, nr. 21, kodi 13630, shuma prej 1647 pika

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Komisioni i cili e bën analizimin e inventarit e dinë edhe në sa zyre i kemi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Shpresoj që murrët informata të mjaftueshme. Kjo pikë nuk votohet, kjo veç kalon.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit për vitin 2022

z.Remzi Salihu: Ne si komitet në kuadër të përgjegjësive tona kemi mbajtur 2 mbledhje për fillimin e planit e kemi të paraqitur planin e punës te komiteti dhe besojë që e keni lexuar dhe shqyrtuar është shkruar në mënyrë të shkurtuar. Unë ju propozojë që ta miratoni këtë nëse jeni dakord.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me 20 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, kalon kjo pikë e renditë të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës se Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Domethënë nga provoja në bazë detyrimeve të drejtorive që kanë në bazë te planit edhe të mëhershëm konsultimin edhe me grupin që veç e kemi formu e kemi bë një propozim të parë që vjen në kuvendë dhe këtë plan me hedhë në diskutim publik duhet të miratohet në seancat e radhës që të ketë vend për vitin e ardhshëm. Për këtë planë që e keni marrë, nëse ka dikush me diskutu, urdhëroni?

z.Ali Bajrami: Këtë propozim vendim ne si grup parlamentarë i LDK mbetet të shohim pasi që kjo nuk do të shkojë në diskutim sot për ta hapur një diskutim. Te diskutimi publik, në datën që është e parapame kur do të mbahet debati publik me qytetarë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Meqenëse është për diskutim publik, mendoj që kisha kërku që përime është mirë që nëse është ndonjë pikë në interes tonin ta planifikojmë më kohë për vitin e ardhshëm, së paku drejtoria e dinë me kohë kur ka me na dhanë një raport për një sen që ne veç e parashtrajmë. Atëherë e qesim ne votim. Me 20 vota për, 0 kundër, 0 abstenim kalon kjo pikë e renditë të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që libri është rregull që çdo vit të miratohet rregullorja mbi të cilën do të mblidhet dhe planifikohet buxheti, të hyrat që do të jenë në vitin e ardhshëm te miratimit të buxhetit shkon edhe me rregulloren me taksa, ngarkesa. Shpresoj drejtori në pika të shkurtra nëse ka diçka me na thanë.

z.Besnik Imeri, drejtori I financave: Nuk ka diçka shtesë përveç çka dimë për temën e diskutimit publik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në bazë të asaj çka e kemi diskutu, rregullorja është komplet e njëjtë, nuk ka ndryshu prej vitit të kalum, janë qato tarifa që kanë qenë për sivjet, e tjetra tarifë ka ardh po me atë diskutimin publik edhe miratimin. Nëse ka ndonjë tarifë që ne dojmë me ndryshu mund ta ndryshojmë, përndryshe kjo rregullore që është kanë vitin e kaluar të njëjtat tarifa nuk janë ndryshu. A jeni që te shkoj në diskutim publik me ngritje dorës. Me 20 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, kalon kjo pikë e renditë të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendim, me numër të Protokollit 01-110/05-216 të datës 04.03.2019

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E kemi marrë një propozim vendim për shfuqizimin e vendimit me numër që e përmendem të vitit 2019. E kemi një vendim gjyqësorë për këtë vendim ka qenë një vendim për vendosjen e shtatores Safet Rexhepi, atje ku është e vendos dhe në kuadër të asaj Ministria e Pushtetit Lokal me kohë na ka sugjeru që më shfuqizu vendimin. Ne si komitet atëherë nuk e kemi kalu që me ardh në kuvend kjo pikë për shkak që ka qenë e ndjeshme dhe Ministria e Pushtetit Lokal e ka dërgu në gjykatë. Unë ja kam dhanë një vendim edhe Liridonës, që ka qenë në komitet dhe ajo gjykata e ka anulë vendimin dhe na ka obligu neve si kuvend me shfuqizu vendimin dhe aludojë që tash me rregullimin e planit mund ta rregullojmë. Ne jemi të obligum për shkak të vendimit gjyqsor që është anulë vendimin, ne duhet me shfuqizu.

z.Musli Neziri: Meqenëse është një vendim i legjislaturës se kaluar, neve na ka ardh në formë te prerë një vendim prej gjykatës, të cilën ligjërisht ndoshta duhet patjetër me rishpall vendimin që e kemi marr, mirëpo ju thatë se me planin rregullativ tash ajo shtatore e dëshmorit aty fakt që është edhe e ndjeshme, andaj nëse ne marrim një vendim për me kthy te mas këtë parcelë ose si do që ka qenë puna në teren, unë po e shohë që me se pari duhet me gjetë zgjidhjen se ku duhet me qu atë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nuk heket ajo, veç vendimin ne duhet me shfuqizu për derisa na e ka anulë gjykata. Tash duhet me gjetë procedura tjera.

z.Musli Neziri: Mendoj që duhet të trajtohet më me seriozitet e jo me marrë ne një vendim sikur atëherë që e ceke, kam pas dëgju që edhe atëherë ka pas problem qysh me fillim qe po na përsëritet neve këtu.

z.Ali Bajrami: Shkeljet procedurale që janë bë atëherë kur ka ardh në kuvend dhe e kemi votu, kem pas shumë pika dhe kemi votu njëzëri. Ata që e cekët pozicioni i jonë si këshilltarë në raport me këtë shfuqizim të këtij vendimi dhe vendimi që kemi votu, qytetari a do të na mirëkuptoj dhe a do të është në gjendje me kuptu se nuk jemi ne këshilltarët që jemi te bë këtë vendim dhe jemi tu deshtë me shfuqizu dhe me hek, por ky është vendim gjyqësor që na obligon që ta bëjmë një veprim të tillë me vullnet. Nuk e kisha votu, po është obligim ligjor, është vendim i gjykatës dhe jam për me zbatu atë.

z.Jakup Demiri: Edhe ne si grup i VV nuk po e komentojmë, nuk po e diskutojmë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë po ju them e kam thirr edhe babën e dëshmorit, e kemi konsultu, kemi mirëkuptim edhe me ta është vendimi i gjykatës nuk e kem qare pa e respektu se veq vendimi është i anulëmë por na duhet me shfuqizu ajo është e kryme duhet me gjet zgjidhje tjetër nëse nuk ka diskutime tjera ju kisha me ngritje dorë për votim. Me 19 vota për 0 kundër 2 abstenim ,miratohet kjo pikë e renditë të ditës.

Si pikë e tetë e rendit të ditës kemi:

8. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik me numër protokollit 01-110/05-476, të datës 04.05.2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Vendimi që e kemi marrë tash prapë ka dalë në ankand publik për shkak të afatit kohorë që ka zgjatë 3 vite që është kanë e parapamë në kuvendë për 3 vite e kemi përcaktu ne afatin kohorë nuk e kemi lënë në komisionin me përcaktu afatin kohor kjo është kanë obligative me ardh prapë në kuvend sepse afati kohorë e ka caktu kuvendi nuk e ka caktu komisioni për këtë arsye ka ardhë me propozim që e keni materialin dhe është propozu që nga 3 vite të jetë në 13 vite.

z.Basri Sylejmani: Propozimi jem është që jo ajo me dominu aty në barnatore sikur me u kanë e vetja.

z.Taulant Haxhiu: Të nderuar këshilltar komunal unë jam pjesë e këtij komisioni u anuloi 3, pse nuk është bërë 5 kush e ka marrë këtë vendim me u bërë 13 e vetmja Komuna e Vitisë që ka barnatore brenda QKMF-së ne asnjë qytet të Republikës së Kosovës nuk ka barnatore brenda QKMF-së. Te konkurrenca nuk ka konkurrencë, ai është i vetmi. Unë kur kam nevojë për barna e kam obligative me marr aty. Kërkund në Kosovë nuk ka, po ky është faj i qeverisjes së kalume që më bjen barrë edhe mu edhe ne po e trashëgojmë. Unë pse jam pajtu me vendimin e kryetarit të partisë, se e tha pak më herët, ne duhet me votu, se përndryshe po mos të kish thënë Bekim Azizi, unë sot këtë barnatore nuk e kisha lan në QKMF, po masi keni bërë vendim, ju veç dine një, që në krejt Republikën e Kosovës vetëm qyteti I Vitisë ka barnatore brenda QKMF-së. Unë e akuzoj qeverisjen e Nexhmedin Arifit, edhe 8 vjet të Sokol Halitit që kemi leju me lan barnatore brenda QKMF-së, po masi keni vendos për 13 vjet, atëherë ne duhet me votu. Ti nënkryetar, ti kryesues i kuvendit, gjenma një barnatore që është në Kosove brenda objektit të QKMF-së.

znj.Lindita Demelezi: Pyetja ime është: perse nuk shfrytëzohet nga QKMF-ja? Sa vërejtje I keni nga inspektoriat farmaceutik për mos përmbushjen e kushteve fizike, profesionale për licencimin e barnatores së QKMF-së? Cilat janë arsyet që nuk po I ofroni me transparencë dhe profesionalizëm farmaceutik barnat? Andaj kërkojë që të keni përgjigje me shkrim dhe propozoj që të merren përgjegjësi për mos përmbushjen për mos formimin e shërbimeve nga barnatorja e QKMF-së.

z.Taulant Haxhiu: Edhe unë kam qenë anëtarë i komisionit, është edhe Dani, pse nuk ka kanë njoftu që po bëhet prej 3 vite në 13 vite as nuk na ka thirr kush në mbledhje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ankandi publik vendimin e ka marrë, ne e kemi bërë vendimin për 3 vite, 3 vite është shpallë ankandi që është e parapamë gjatë ankandit publik, që është procedurë ligjore në vendimin që e marrim edhe këtë ata e kanë për detyrë me qit në ankand, kurë të konkurrojnë, atëherë merret komisioni edhe i shqyrton, nuk kanë konkuru komisioni, nuk është mbledh komisioni, është hala aktiv edhe këtë vendim kur e ka bërë te na prapë këta kanë ardh te i njëjti komision, komisioni nuk është ndryshu dhe neve na ka ardh një propozim i ri e ne e diskutojmë e bëjmë 5 vite, 8 vite, 10 vite deri 15 maksimumi, ne e kemi të drejtën, ky është propozim, brenda propozimit mundet me na dalë pjesë tjera.

z.Ramadan Deliu: Unë jam kanë në qatë komision, Taulanti nuk ka ardh hiq, jemi mbledhë komisioni, kemi shku te Zyra e Prokurimit, Taulanti nuk ka ardh hiq, ne e kemi pas deri me 18 me shku te Zyra e Prokurimit, jemi kanë unë, Albulena, Taulanti nuk ka ardh, e kemi kqyr aty nuk ka qenë kërkush, neve na e kanë bërë ofertën e vendimi merret këtu.

z.Ilir Zuka: Neve na ka ardh një propozim vendim që e kemi diskutu edhe me sekretarin, që është gabim, e kam thanë, edhe Drejtoria e Kadastrit se kanë konsultu me Zyrën Ligjore hiq edhe ky propozim vendimi që ka ardh është në rregull, edhe për vitet e kemi në kuvend edhe e gjejmë një gjuhë të përbashkët.

z.Taulant Haxhiu: Dan, dëgjo edhe një herë, unë me 18.07 mua nuk më ka thirr kërkush.

z.Ramadan Deliu: E ke marrë letrën.

z.Taulant Haxhiu: Mu letër nuk më ka dhanë kërkush, unë letër nuk kam, se ma lehtë e kanë pas me ty, të kanë thanë qysh dush e me mu e kanë pas ma zor, për qata nuk me kanë thirr.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Unë po mendoj se ne po dojmë me u kthy në pikën 0. Ne vendim si vendim edhe ligjshmërinë a është kanë fajtorë ish qeveria a jemi fajtor ne është çështje tjetër. Në momentin që neve na ka ardh që është ligjor. A ka nëpër Kosovë nuk e di, nuk e kam shëtit krejt Kosovën, në momentin kur Ministria e Pushtetit Lokal e ka konfirmu ligjshmërinë dhe atë ligjshmëri e ka për obligim kryesuesi, se është kthy akt i ligjshëm, ne kemi shku në hapin e më tutjeshëm për formimin e komisionit nga përbërja juaj, të cilën ju e keni të drejtë me i ja dhanë atij i cili ofron kushte më të mira për komunë. Ky

propozuesi ka drejtë me propozu, ky mundet me shfrytëzu maksimumin dhe në afat të shkurtë dhe në afat të gjatë, dhe në këtë drejtim nuk kemi nevojë shumë me politizu, por unë besoj se edhe si kuvend do të kishim ra poshtë bashkë me ekzekutivin në rast se e bëjmë një afat tjetër dhe serish nuk na konkurron askush.

z.Basri Sylejmani: Unë veç ta dijë a është në mënyrë ligjore për me u dhanë. Si të është në mënyrë ligjore ajo është diçka tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Basri, vendimin që e kemi marrë ne prej ministrisë e dimë që është ligjorë.

z.Nexhat Halili: Në bazë të analizës së kësaj gjendje, kam ardh në përfundim se, në bazë të ligjit parashihet dikun deri në 15 vite, po në bazë të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Palujatshme të Komunës me numër 063092. Unë e kam një pyetje, publikimin e njoftimit për ankand a e ka bë komisioni vlerësues a e ka bë dikush tjetër? Unë këtu te publikimi kam vërejtje, publikimin e njoftimit publik e keni bë ju si komision, këtu në pjesëmarrjen e ankandit publik i lejohet vetëm personave juridik po jo edhe personave fizik. Në bazë të këtij ligji i lejohet personave fizik dhe juridik dhe shoqërisë civile, mirëpo në bazë të këtij njoftimi publik, është vetëm për persona juridik. Pse ka ndodhë kjo?

z.Illir Zuka: Në moment që na ka ardh ky propozim ndryshim, ai ka ra në pikën 0. Ne po e ndryshojmë, qëllimi është me bë zgjidhje dhe duhet me kalu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ilir, propozimi nuk ka ra në pikën 0, se nesër mundet me dalë ne ankand për 3 vjet, se për 3 vjet është miratu, s'ka ra në 0 ne me ndryshu propozimi është veç afatin me zgjatë, vendimi është valid, ka konfirmim prej ministrisë që nesër mundet me shpallë procesin me përsërit.

z.Ramadan Deliu: Në ankand a ka dalë, ai ishte duke paguar 720 euro ish tu pagu ai, tash kush të donë mundet me konkuru.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Unë besoj që Nexhati këto çështje i dinë, personi fizik nuk ka të drejtë me konkuru, se për me konkuru duhet me pas kompani të regjistruar, andaj për atë person fizik jam unë domethënë çka paraqes aty, unë nuk mundem me shit barna. E dyta, Iliri e bëri një ndërhyrje. Ilir, po ta mësoj edhe një termë. Vendimi në bazë çka e kemi marrë ne, në vendim është për me dhanë diçka dhe për atë ne duhet të ja bëjmë hapësirën dhe nuk jemi tu ndryshu, ne jemi tu i ndryshu vetëm vitet, objekti nuk është tu ndryshu, e dinë Nexhati fortë mirë, deri vonë e ka pas Zyra e Prokurimit për shkak të konstatimeve te nivelit qendror, që mundet me pas njëanshmëri, ka caktu, se nuk ka dhe nuk guxon me dhanë përmes Zyrës së Prokurimit, po duhet përmes kuvendit, dhe çka është me rëndësi mbas 2 vite kemi dalë përmes kuvendit për me dhanë listën. Duhet aprovu më se largëti deri në Dhjetor, të cilat të dhëna kuvendi është interesu me tejkalu

z.Nexhat Halili: Nënkyetar, unë e n dëgjova përgjigjen tuaj, mirëpo ky propozim vendim që është nënshkru prej kryetarit se nuk është i nënshkru prej teje e cek vet ky ligj, neni 2, persona fizikë dhe juridikë edhe ky ligj me numër të cilin ta përcakton prej 1 deri ne 15 vite afat, shkurtë dhe ky ta përcakton, thotë persona fizikë dhe juridikë edhe bizneset individuale. Tash edhe bizneset individuale janë në emra të personave fizik.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: A e dinë çka është person fizik?

z.Nexhat Halili: Person fizike e di.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Jo nuk po e dinë.

z.Nexhat Halili: Nëse e dinë më mirë, atëherë kërkesën tënde e shkrun pak më mirë, un po flasë në bazë të dokumenteve, në bazë të ligjit, nuk po flasë me hamendje, në bazë të pikës që ju e keni plotësu, jo unë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Duhet me ditë çka është personi fizik dhe juridik.

z.Nexhat Halili: E dijë shumë mirë, merre analizoje nëse donë me këto ta përcakton ta përcakton biznesin individual dhe a është person fizik.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Nuk ka biznes që është i regjistruar që ka emërtim që është kanë persona fizikë.

z.Basri Syljemani: z.Kryesues, ne e pyesim njeriun që është përgjegjës si jurist, ky po thotë se kemi të drejtë. Ju keni thanë 13 vjet e unë po propozojë për 7 vite, propozimi jem përgjyestë këputë.

z.Ali Bajrami: Propozim vendimi që e kemi për plotësim ndryshim, pse propozim vendim shkrun person fizik, askund nuk shkrun në këtë propozim vendim, shkrun sipërfaqja 65 metra katror, nuk shkrun veprimtaria, se çka ka me u zhvillu në të, unë nuk po e shohë nëse nuk ka veprimtari, ne jemi tu fol kotë, se nuk jemi te dhanë për barnatore kushdo që aplikon mundet me marrë me qel qajtore në bazë të këtij propozim vendimi. Mos me ardh ne lajthitje si kuvend, si këshilltarë, unë për kridibilitetin tem personalë po flasë po edhe të gjithë këshilltarëve. Kërkojë nga drejtoresha e shëndetësisë edhe nga Zyra Ligjore e kryetarit me lyp interpretim ligjor, a ka drejtë a nuk ka të drejtë. Vitia është sui generis sa i përket dhënies së hapësirave publike shtetërore firmave private, nuk ka në Kosovë kërkund se vijë prej kësaj veprimtarie edhe e njofë edhe e dijë. E vetmja është Vitia nuk po thojmë me dhanë po me ja dhënë, këtu janë bë pazare për 3 vite nuk po konkurojë për 13 vite, unë po konkurroj kush është ai me mu nuk ka fol kërkush.

z.Jakup Demiri: Në çka kemi kqyr, çka kemi mujt me hulumtu është që, vetëm Vitia ka barnatore private brenda QKMF-së. E dyta, që nuk kanë barnatore aktive Qendrat e Mjekësisë Familjare është Vitia edhe Kaçaniku, të tjerat nuk kam mundur t'i gjejë, edhe këtu duhet me punu me strategji që me pas QKMF-ja një barnatore të veten. Alia e tha edhe më mirë, se vjen edhe prej kësaj veprimtarie, ne e kemi hulumtu që brenda QKMF-së vetëm Vitia dhe Kaçaniku kanë barnatore, ndërsa dhënia me qera QKMF-së për brenda hapësirave të veta, objekt me qera për barnatore, s'ka rëndësi a është 15 vite a 13, po qëllimi është strategjia me hulumtu se si shkon. A kjo për 3 vite që nuk ka konkuru askush nuk është për t'i besu.

z.Illir Zuka: Janë diku 724 euro në muaj e mbi 8 mijë e sa euro në vit për një barnatore. Unë besoj që i kontribuon edhe shëndetësisë që i marrinë ato mjete, ajo është e hapur, ka mundësi me konkuru kush të donë, ai që e ka ofertën më të mirë komuna e jep. Po krejt çka kem të diskutu Taulanti e këta të tjerët ke për kohën se nuk ke në pyetje a me dhanë a mos me dhanë nëse ka përfitim prej saj pse mos me dhanë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Qeky komision që ka dalë prej këtij institucioni më të lartë, me 27 vetë, kërkush nuk e privon askënd në kushtet me të cilat bëhet thirrja me konkuru dhe në rast se këtij zotënisë i paskan kërkush të cilën, un nuk e di, 724 euro, ne ti konkurron dikush 900 euro tani pe kqyrem e pe merr ai. Ne e kemi qitë thirrjen, tash konkurrojnë 5 apo 6 persona, komisioni e ka për obligim ligjorë me ja dhanë atij që i ka kriju kushtet më të mira, që ka komuna përfitim. Ju e dini se e kemi edhe rregulloren, lejohen hapësirat, për taksat komunale ka për obligim e në mesin e atyre është edhe kjo, e tash është interesi më i madh a me dhanë a mos me dhanë, ju jeni ata që e keni përcaktu për me dhanë. Sot jem tu diskutu për çështjen e viteve, doni me dhanë për 3 vite që nuk është i interesum askush, i thoni komisionit përsërite edhe një here, ka me përsërit, i thoni jepne për 5, vendimi juv vendos, propozuesi duhet me ardh me propozim.

z.Taulant Haxhiu: Mua po më duket 13 vite shumë, unë propozoj që të jetë afati 5-vjeçar.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mua po më vie keq për vendimet tona të kuvendit, që e kemi ligjshmërinë prej atjehit me bë debat për ligjshmërinë a mundemi apo nuk mundemi kjo është temë e kryme, se është ligjshmëria prej MAPL-së. Ne krejt e dimë, po ne jemi tu e diskutu vetëm këtë për 3 vite, nëse nuk e vazhdojmë këta e përsëritin edhe njëherë, nëse e vazhdojmë për më shumë e miratojmë këtu. Ne nuk mundem me anulë, se duhet me ardh në seancat tjera, sot është vetëm koha. A kemi vullnet me vazhdu me afat më të gjatë.

z.Jakup Demiri: Po e shofë që kjo është një dokument që është votu e për me ja dhanë e mos me ja dhanë dikujt, kjo është nënkryetar, këto janë vendimet e juaja.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Jakup, po të sigurojë se nuk sigurojë kurrë pa ja imponu komisionit. Konkuro ti me 1 mijë qeky, komision nuk ja banë ndërgjegjja pa ta dhanë ty ti ki me marrë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Vendimi është i propozum, vendimi është ligjor, nuk mundemi ne asgjë me ndryshu vetëm kohën për sa me dalë. Kemi 2 propozime, unë mendojë që me shku 5 vite, Taulanti propozoj, po mendojë që është pakë.

z.Ali Bajrami: Në emër të grupit të LDK e mbështes atë që tha Basria për 7 vite, po jashtë asaj Drejtoria e Shëndetësisë me bë kërkesë me na e konfirmu në mënyrë ligjore që në seancën në shtatorë me pa konfirmimin prej MAPL-së, a është e ligjshme apo nuk është, mos me ardh ndesh si në vendimin paraprak.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ali, edhe këtë afat çka ta caktojme sot edhe qëky ka me shku në ministri edhe ministria ka me na e kthy prapë a është e ligjshme apo jo. I kemi 2 propozime që kanë ardh sot, për 7 vite edhe për 5 vite. Unë e kam për obligim me i qitë të dyat në votim. Pe shofë që disponimi për afate më të gjata nuk është, unë po them që është pakë. Kush është që në ankand të jepet për 5 vite me propozimin e Taulantit. 16 janë pro, 0 kundër, 0 abstenim. Momentin që kalon propozimi parë propozimi i dytë nuk del në vota.

Si pikë e nënte e rendit të ditës kemi:

9.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë në Shqipëri, shkëmbim provojave dhe thellim i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel lokal në mes të dy komunave, Bashkia e Tiranës njësia Administrative Krrabë dhe komuna e Vitisë

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kemi edhe një kërkesë që na ka ardhë me postë e dinë edhe sekretaria që Bashkia Administrative e Krrabës ka bë një ftesë që kuvendi komunal me vizitu edhe është dashtë me marrë një vendim kuvendi dhe këtë vendim duhet ta bëjmë te përbashkët. Nëse ka dikush për temë, urdhëroni?

z.Ramadan Deliu: 1:16:20.4 nuk ka folur me mikrofon i pa mundur ndegjimi

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kuvendi komunal, mjetet nga shërbimet dhe mallrat dihet që në vitet janë bartë dhe ato mjete prapë kanë me na u bajtë ne vitin tjetër. Seancën e kalume e kemi vendosë që me blej llaptopa, kemi mjete edhe që me bë një vizitë, domethënë që është një pare që sun e dërgojmë tjetër kund po ne mundemi me shfrytzu me bë një vizitë, një provojë. Unë e kam marrë këtë iniciativë edhe në koordinim më ju dhe e kam pru për sot.

z.Taulant Haxhiu: Shumë mirë që na ka ardh mundësia me shku bashkë si kuvendë në Shqipëri, unë jam po masë pushimeve verore, prej 10 deri 15 shtatorë është koha më e mira më e përshtatshmja që ne si kuvend të shkojmë bashkë, unë si shef i grupit parlamentarë e përkrahi këtë propozim tëndin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Neve na vyn edhe ligjshmëria, procedurat dhe për atë arsye duhet me hec me kohë që me shfrytzu në mesin e Shtatorit. A jeni për? 19 janë pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi